




Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri


**Raporti i Akademisë së Filmit dhe
Multimedias Marubi
Maj 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Znj. Beatrice Ollerenshaw Kryetare



2 Profesor John Baldock Anëtar



3 Dr. Alketa Grepcka Anëtare



Datë: 25 deri në 26 maj 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raporti i detajuar.....	10
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	10
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	16
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	22
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	27
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre.....	31
Lista e dokumenteve	35

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi (AFMM, Akademia) është një institucion i specializuar publik, i pavarur dhe me vetëfinancim. Ai është institucion laik dhe jopolitik. Misioni i AFMM-së është të ofrojë arsimim dhe kualifikime profesionale, krijuese, artistike dhe teknike. Vizioni i Rektorit është të formojë regjisorë të rinj, që të mund të reflektojnë trashëgiminë e tyre dhe të vendit të tyre, si dhe të analizojnë historitë që ajo ofron, gjë që e sheh si sfidë në botën e komunikimit të çastit dhe informacionit kalimtar.

AFMM-ja ka një fakultet dhe ofron një program të ciklit të parë, që siguron diplomë Bachelor si Specialist i Lartë në Film dhe Media, dhe në profilet Regjisorë, Skenar, Kamera dhe Montazh, temë e cila pasqyron aftësi të specializuara të përzgjedhura për zhvillim nga studentët. AFMM-ja ndodhet në Tiranë, në zonën e njohur si Kinostudio. Aty pranë ndodhet edhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, e cila është në pronësi të shtetit, dhe më parë ka qenë studio shtetërore e filmit, që siguronte salla të dobishme për shfaqje dhe studio me izolim akustik. AFMM-ja është anëtare e CILECT (Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave të Filmit dhe Televizionit) dhe ka një larmi lidhjesh ndërkombëtare. Shumë prej studentëve të AFMM-së kanë punuar në fushën e filmit dhe televizionit, disa prej të cilëve menaxhojnë kompanitë e tyre, përmes së cilave mund të punësojnë të diplomuar të ardhshëm të AFMM-së, ndërsa disa të tjerë japin mësim me kohë të pjesshme në AFMM.

AFMM-ja u themelua në vitin 2004, nga shtëpia kinematografike Orafilm, me mbështetjen e Shoqatës së Kineastëve Shqiptarë Lumière, si institucioni i parë i kualifikimeve të larta profesionale në fushën e filmit dhe multimedias në Shqipëri, për trajnimin e të rinjve që duan të punojnë në këtë fushë. Së fundmi, Orafilm ka marrë të gjithë përgjegjësinë për financimin e saj, dhe shumë prej pajisjeve të specializuara sigurohen po nga Orafilm dhe partnerë të tjerë, apo sponsorë të projektit. Gjatë vitit 2017, si rezultat i ndryshimeve në legjislacion dhe i një Vendimi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, AFMM-ja do të jetë pjesë e Fondacionit Kinostudio të krijuar së fundmi, si dhe do të gëzojë të drejtën e financimit shtetëror si Akademi me status të veçantë. Kjo do i ofrojë AFMM-së më shumë siguri financiare, si dhe do sigurojë përdorimin e vazhdueshëm të godinës.

AFMM-ja është e ndarë në katër departamente akademike (kamera, montazh, skenar dhe regjisorë) nën strukturën e përgjithshme të njësisë së prodhimit. Prurjet janë kufizuar në vetëm 15 studentë të regjistruar në të gjitha vitet e programit. Numri i tyre i përgjithshëm ra nga 15 në vitin 2014-2015 në 9 në vitin 2015-2016, megjithëse u rrit sërish në 15 në vitin 2016-2017. AMF-ja, që prej themelimit të saj e deri më sot, ka diplomuar 55 studentë. Ajo ka pasur edhe disa studentë shqiptarë nga Maqedonia dhe Kosova, dhe do të dëshironte të zgjeronte prurjet e saj me studentë nga vende joshqipfolëse. Pjesa më e madhe e stafit punojnë me kohë të pjesshme pasi janë profesionistë në fushën e filmit dhe medias. Stafi akademik përbëhet nga 4 pedagogë me kohë të plotë dhe 11 me kohë të pjesshme. Numri i tyre ka rënë gjatë tre viteve të fundit, ku janë larguar katër pedagogë dhe janë rekrutuar vetëm dy. Ka vetëm dy profesorë ose asistentë profesorë, njëri prej të cilëve ka doktoraturë. Në të tria njësitë (njësia e prodhimit, administrimit dhe rektorati), personeli administrativ dhe ai mbështetës ka vetëm 5 anëtarë me kohë të plotë.

Raport i përmbledhur

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi (AFMM; Akademia) e përgatiti Raportin e Vetëvlerësimit (RVV), së bashku me dokumentacionin mbështetës, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit. Për hartimin e tij u mbledh një panel prej katër anëtarësh, duke përfshirë edhe një përfaqësues të studentëve, ndërsa projektraporti u diskutua me anëtarët e tjerë të administratës së shkollës. Në RVV pranohej se aspektet e Standardeve Shtetërore të Cilësisë ishin sfiduese për AFMM-në, duke argumentuar se ato nuk janë lehtësisht të zbatueshme për një institucion të vogël të specializuar në fushën e filmit dhe medias. Kjo vlen veçanërisht për disa prej standardeve që lidhen me kërkimin, ku nuk u vunë në dispozicion dokumente, dhe që AFMM-ja, si Akademi me status të veçantë, nuk është e detyruar t'i trajtojë. Në RVV pohohej se AFMM-ja kishte vuajtur për shkak të konkurrencës me institucionet e tjera, që ofrojnë më shumë programe studimi teorike, por në të shprehur edhe shpresa se ndryshimet në politikën e qeverisë do të mundësonin lulëzimin e saj. RVV-ja ishte e mirëstrukturuar, me referenca të qarta për dokumentet e dorëzuara, dhe ishte shkruar në gjuhën angleze, me rrjedhshmëri të jashtëzakonshme. Megjithatë, i mungonte vlerësimi kundrejt standardeve dhe nuk jepte sugjerime se çfarë duhej të bënte vetë Akademia me nismën e saj për trajtimin e çdo mangësi në lidhje me standardet.

Vizita u krye përgjatë një dite e gjysmë, përkatësisht në datat 25 dhe 26 maj 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit në emër të APAAL-it dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori në konsideratë RVV-në dhe dokumentet mbështetëse, që përshkruanin strukturat, politikat dhe procedurat që mbështesin veprimtarinë akademike të AFMM-së, dhe i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm kryerjen e vlerësimit kundrejt Standardeve Shtetërore të Cilësisë. Dokumentet përfshinin Statute dhe Rregullore, marrëveshje dhe ndërveprime me organizatat partnere, dhe informacione për kurrikulën, si dhe referenca për faqet e internetit, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kishte akses. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi para kryerjes së vizitës disa dokumente shtesë, të cilat iu vunë në kohë në dispozicion nga AFMM-ja.

Gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe me partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit. Diskutimi me këto grupe i mundësoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të qartësonte procedurat dhe përgjegjësitë institucionale, dhe të shqyrtonte mendimet e grupeve të ndryshme të njerëzve. Një anëtar i personelit të APAAL-it dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbajtën shënime në të gjitha mbledhjet. Një anëtar i personelit të AFMM-së ofroi ndihmë tejet të vlefshme me përkthimin gjatë vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri një tur, për të parë ambientet e disponueshme për personelin dhe studentët.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi marrëdhënien ndërmjet AFMM-së dhe kompanisë së saj aktuale mëmë (Orafilm), si dhe u informuan lidhur me faktin se ndryshimet e fundit në legjislacion dhe politikën e qeverisë do ta bënin AFMM-në pjesë të Fondacionit Kombëtar Kinostudio. Kjo do të siguronte pozicionin e saj financiar dhe të drejtën e përdorimit të godinës. AFMM-ja është nën trysni të madhe financiare, për shkak të numrit shumë të ulët të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se kjo gjë ka kontribuar në dobësitë lidhur me personelin, fakultetin dhe strukturat e departamenteve, mundësitë për debat dhe administrimin e godinës. Gjithashtu, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandime për trajtimin e tyre në kontekstin e ri të administrimit.

AFMM-ja ofron një program, që iu lejon studentëve të eksplorojnë një larmi veprimtarish, që lidhen me filmin dhe multimedian në vitin e parë, pas të cilit ata specializohen në një prej

katër fushave të aftësisë: kamera, regjisorë, skenar dhe montazh. Studentët punojnë si ekip i prodhimit të filmave, duke përdorur të gjitha këto aftësi për ofrimin e një produkti përfundimtar, që është vlerësuar. Kjo mbështet gjithashtu edhe nga mësimi i teorisë. Punëdhënësit vlerësojnë faktin se të diplomuarit e AFMM-së kanë pasur përvojë praktike dhe mendojnë se pasja e një filmi për t'u shfaqur, i ndihmon ata të gjejnë vende pune. Studentët e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishin shumë të artikuluar dhe të gatshëm për të diskutuar rreth përvojave dhe ambicioneve të tyre. Ata bënin krahasime të argumentuara me institucionet e tjera dhe me botën profesioniste të prodhimit të filmave në Shqipëri dhe më gjerë.

Stafi mësimdhënës ka përvojë shumëvjeçare si profesionistë të medias në shtetet e Evropës dhe SHBA-së. AFMM-ja ka një sërë partneritetesh brenda dhe jashtë vendit, dhe është pjesë e CILECT, që bën ndërlidhjen me institucionet e filmit dhe medias në vende të tjera të Evropës. Si rezultat i këtyre lidhjeve, personalitete ndërkombëtare në industrinë e filmit dhe medias ofrojnë orë të veçanta mësimore fizikisht ose nëpërmjet videokonferencave. Këto lidhje i kanë dhënë gjithashtu akses AFMM-së në projektet evropiane të medias, që kanë qenë të vlefshme dhe kanë sjellë dhurimin e pajisjeve, që në të kundërt AFMM-ja nuk do të kishte mundësi t'i përballonte. Pjesa më e madhe e stafit mësimdhënës punojnë me kohë të pjesshme, duke qenë se janë edhe profesionistë të medias, ndërsa studentët përfitojnë nga kontakti i vazhdueshëm me ta, veçanërisht kur angazhohen në prodhimin praktik të filmave. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i konsideron këto lidhje si praktikë të mirë.

Si profesionistë të medias, stafi akademik nuk ka ekspertizë në pedagogji, dhe nuk ka asnjë proces formal për menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Stafi i AFMM-së mendon se standardi i filmave që ata dhe studentët prodhojnë është i mjaftueshëm për të treguar cilësinë e mësimdhënies. Megjithatë, mbështetja vetëm të profesionistët e medias me kohë të pjesshme nënkupton që AFMM-së i mungon stafi akademik bazë me ekspertizë pedagogjike. AFMM-ja nuk e ka njësinë e vlerësimit të cilësisë. Këndvështrimet e studentëve nuk merren më përmes pyetësorëve, dhe ata mendojnë se mendimet e tyre nuk janë marrë në konsideratë. Këshilli Studentor nuk është efikas, ose nuk njihet nga studentët. Roli statutor i Këshillit Akademik për mbikëqyrjen e mësimdhënies nuk po përmbushet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka dhënë rekomandime për trajtimin e këtyre dobësive.

Komunikimi me studentët bëhet nëpërmjet këndit të njoftimeve, emailit dhe faqes së internetit. Faqja e internetit është e kuptueshme dhe e mirëprojektuar, si dhe përmban informacionin bazë për Akademinë, programin e saj dhe procesin e pranimeve. Kërkesat e pranimeve janë përcaktuar qartë dhe vlerësojnë të kuptuarit dhe dhuntitë e studentëve për prodhimin e filmave. Sipas studentëve, procesi i pranimeve është i qartë dhe stafi akademik iu jep atyre informacion për programin në fillim të studimeve të tyre. Akademia nuk ka Zyrë Karriere, pavarësisht caktimit të anëtarëve të stafit për këshillimin e studentëve rreth mundësive për punësim. Ajo ruan ende lidhjet me alumni, por nuk mban të dhëna sistematike për punësimin e të diplomuarve, dhe si rrjedhojë mungon analiza e tyre, dhe dokumentet mbi të cilat bazohet përgatitja e kurrikulës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha një rekomandim për këtë fushë.

AFMM-ja nuk i ka përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë në një sërë fushash për shkak të mungesës së proceseve të qarta, dhe mospërdorimit të bordeve dhe këshillave për debate dhe konsultime. Planet e zhvillimit nuk janë diskutuar gjerësisht dhe nuk përfshijnë mjetet nëpërmjet të cilave të mund të realizohen, ashtu siç buxhetet nuk janë diskutuar me stafin ose me strukturat formale. Proceset e dokumentuara për rekrutimin e stafit akademik mungojnë, dhe kolegët nuk përfshihen në procedurat e emërimit. Ankimimet e studentëve për notat nuk menaxhohen në mënyrë transparente. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka dhënë disa rekomandime për trajtimin e këtyre çështjeve.

Në përgjithësi, gjykohet se standardet në AFMM janë përmbushur pjesërisht pasi standardet në katër fusha vlerësimi janë përmbushur kryesisht, ndërsa në të pestën janë përmbushur pjesërisht. Gjithashtu, Akademia nuk e kaloi pragun e gjykimit të përgjithshëm “përmbushur pjesërisht”, gjë që do të thotë se gjykimi në të gjitha fushat duhet të ishte ‘përmbushur kryesisht’ ose ‘përmbushur plotësisht’. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se mostrajtimi i rrezeve të identifikuar, të pasqyruara në rekomandime, do të krijonte rrezik mesatar me kalimin e kohës, dhe se pasqyrojnë dobësitë e strukturës drejtuese lidhur me cilësinë dhe standardet, dhe pengesat lidhur me përpikërinë me të cilën janë zbatuar procedurat. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoi se planet dhe zbatimi i tyre nuk janë bërë plotësisht pjesë e Akademisë, dhe se kjo e fundit nuk është e ndërgjegjshme për rëndësinë e çështjeve kryesore të pasqyruara në rekomandime.

Në arritjen e këtyre gjykimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ose pohoi fushat ku Akademia ka pranuar se ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha një sërë rekomandimesh për AFMM-në, që të merren në konsideratë si një mënyrë për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të saj dhe përvojës së mësimxënies së studentëve të saj.

AFMM-ja e ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dëshiron të vlerësojë angazhimin e Akademisë në proces dhe bashkëpunimin e saj me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, duke përfshirë edhe mbështetjen e vyer nëpërmjet përkthimit gjatë takimeve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur pjesërisht në një fushë dhe kryesisht në katër fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi fushën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet ndërkombëtare, që kanë mundësuar organizimin e orëve të veçanta të specializuara, dhe kontribute të tjera nga specialistë dhe profesionistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e prodhimit të filmave, qoftë fizikisht apo nëpërmjet videokonferencave, për përmirësimin e studimeve të studentëve dhe përvojën e tyre kulturore (pika 1.9, 5.3, dhe 5.8; **Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3, Kapitulli I Standardi III.3, Kapitulli I Standardi III.8**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e pozicionit të Kancelarit, që ndikon në funksionimin efikas të AFMM-së në përputhje me Statutet (pika 1.1; **Kapitulli III Standardi I.1, Kapitulli III Standardi I.2**)
- Standardet Shtetërore të Cilësisë, lidhur me strukturat dhe stafin akademik nuk janë përmbushur (pika 1.3; **Kapitulli III Standardi I.2, Kapitulli III Standardi II.1**)
- Këshilli Akademik nuk ushtron rolin e tij kolegjal në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimnxënies. Kjo përbën debat konstruktiv dhe nënkupton se Akademia nuk mund të ushtrojë përgjegjësinë e saj për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës së saj siç përcaktohet në Statute (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi II.3**)
- planet nuk janë diskutuar gjerësisht apo monitoruar nga Bordi dhe Këshilli, ndërsa plani i Akademisë nuk përfshin mënyrat e zbatimit të tij (pikat 1.5 dhe 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi I.5**)
- nuk ka të dhëna sistematike për punësimin e të diplomuarve, që si rrjedhojë nuk është i disponueshëm për të mbështetur përgatitjen e kurrikulës (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi III.9**)
- mungesën e angazhimit të stafit akademik në procesin e rekrutimit të stafit, dhe faktin se procesi nuk është dokumentuar plotësisht (pika 2.1; **Kapitulli III Standardi IV.1**)
- mospërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme, për t'iu dhënë studentëve mundësinë e shprehjes së mendimit të tyre rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e AFMM-së (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli III Standardi IV.3, Kapitulli I Standardi II.3**)
- faktin se buxheti nuk është diskutuar me stafin (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VI.1**)
- mungesën e një anëtari me kohë të plotë të stafit akademik për të ofruar udhëheqjen pedagogjike në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe udhëzime akademike të pavarura për studentët (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi I.8**)
- mungesën e një procesi për menaxhimin e ankimeve të studentëve për notat e provimeve (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- mungesën e një strukture dhe procesi sistematik për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- mungesa e angazhimit të Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimnxënies, që është përcaktuar në Statute (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- emërimin e një personi në rolin e Kancelarit për sigurimin e pasqyrit të Statutit të tij nga struktura e tij drejtuese brenda gjashtë muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.1; **Kapitulli III Standardi I.1, Kapitulli III Standardi I.2**)
- përgatitjen e një plani për sigurimin e pasqyrit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë lidhur me strukturën, si dhe udhëheqjen e fakultetit dhe stafit të njësive të departamenteve nga struktura e tij drejtuese brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.3; **Kapitulli III Standardi I.2, Kapitulli III Standardi II.1**)
- sigurimin e përmbushjes së rolit kolegjal të Këshillit Akademik për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies, të përcaktuar në Statute, brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi II.3**)
- sigurimin se Strategjia ose Plani i Zhvillimit janë diskutuar gjerësisht dhe përfshijnë mënyrën për arritjen e rezultateve të propozuara brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pikat 1.5 dhe 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi I.5**)
- ndjekjen e një procesi sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, dhe sigurimin se informacioni është përdorur për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli III Standardi III.1, Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi III.9**)
- sigurimin se stafi akademik përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit dhe se vetë procesi dokumentohet plotësisht brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 2.1; **Kapitulli III Standardi IV.1**)
- ripërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme, për t'iu dhënë studentëve mundësinë të shprehin mendimin e tyre për cilësinë e leksioneve dhe punën e stafit akademik, në përputhje me Statutet e tyre, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli III Standardi IV.3, Kapitulli I Standardi II.3**)
- sigurimin se buxheti është diskutuar me stafin në bordet dhe këshillat e dhura, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VI.1**)
- shtimin e një akademiku me kohë të plotë me përvojë dhe formim në teori dhe praktikë për arsimin e lartë në stafin e saj, i cili mund ta këshillojë stafin me kohë të pjesshme për metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, dhe të ofrojë udhëzime akademike të pavarura për studentët brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi I.8**)
- dokumentimin e qartë dhe zbatimin në vazhdimësi të procesit të menaxhimit të ankimimeve të studentëve për notat e provimeve, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- ngritjen dhe zbatimin e një procesi sistematik dhe strukture të përshtatshme për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies brenda 18 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- sigurimin e angazhimit të Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimdhënies, të përcaktuar në Statute, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur pjesërisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur pjesërisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 AFMM-ja drejtohet nëpërmjet Statuteve, [1] ku pohohet se Rektori është autoriteti më i lartë, i cili i raporton Orafilm, shoqërisë së filmit që themeloi Akademinë, dhe të gjitha organet e AFMM-së i raportojnë atij (Bordi Këshillimor, Këshilli Akademik, Njësia e Prodhimit dhe personeli administrativ). Si një organizatë e vogël me vetëm një fakultet, që ofron një program dhe ka vetëm 15 studentë, [GID] menaxhimi kanalizohet nëpërmjet Rektorit, që harton dhe monitoron Planin e Zhvillimit të AFMM-së dhe mbikëqyr menaxhimin e të gjitha burimeve, rregulloreve, dhe lëshimin e diplomave të studentëve. [1; M1; M2] Këtu përfshihet edhe shpërndarja e burimeve njerëzore, [1; M2] për përmbushjen e nevojave të programeve të mësimdhënies. Njësia e Prodhimit ka katër nënndarje ose departamente: regjisorë, montazh, kamera dhe skenar. Drejtori i Prodhimit është Drejtori Ekzekutiv i Orafilm [1] dhe është përgjegjës për bazën teknike të AFMM-së, të nevojshme për zhvillimin e programeve. [RVV fq.4] Rektori, që jep edhe mësim, është Përgjegjësi i Departamentit të Regjisorëve, [7] që është pjesë e Njesisë së Prodhimit. Në pozicionin e Kancelarit nuk është emëruar ende asnjë, me qëllim kursimin e parave [M2], por ky pozicion është përcaktuar edhe në Statute. [1] Kancelari është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm administrativ dhe financiar të Akademisë, për zbatimin e buxhetit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e transaksioneve financiare, si dhe për zbatimin e ligjit, dhe vepron si urë lidhëse ndërmjet drejtuesve dhe Këshillit Studentor (shihni gjithashtu pikën 5.7). [1] Akademia ka nevojë për një Kancelar që t'i mundësojë asaj funksionimin efikas, në përputhje me Statutet, dhe si rrjedhojë në pajtim me **Kapitullin III Standardet I.1 dhe 1.2**. Prandaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e sheh si **dobësi** mungesën e pozicionit të Kancelarit, që ndikon në funksionimin efikas të AFMM-së, në përputhje me Statutet, dhe **rekomandon** që Akademia të emërojë dikë në këtë pozicion, për sigurimin e pasqyrimin të statuteve në drejtimin e saj, brenda gjashtë muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. [**Kapitulli III Standardi I.1, Kapitulli III Standardi I.2**]

1.2 Burimet për drejtimin e AFMM-së janë të kufizuara. Numri i studentëve është i ulët [**dok. shtesë 6; GID**], ku numri i studentëve të regjistruar për vitin akademik 2016-2017 është vetëm 15. [**Dok. shtesë 6**] Megjithatë, Rektori dhe stafi [M1; M2; M5] nuk dëshirojnë që të shtojnë numrin e studentëve, pasi i tremben uljes së cilësisë së studentëve. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu tha se pajisjet e reja varen nga mbështetja e Orafilm [**faqja e internetit**] dhe partnerëve të tjerë. [M1] Kamerat moderne janë ofruar nëpërmjet një projekti të ndërmarrë me mbështetjen zvicerane [M4], ndërsa pajisjet e tjera janë dhuruar nga qeveria gjermane. [M1] AFMM-ja e ka të vështirë që të përballojë blerjen e librave [M5] dhe ofrimin e bursave [M4], si dhe nuk mund të përballojë rinovimin e kinemasë. [**tur në terren**] Pozicionet e Kancelarit [M2] dhe punonjësit të bibliotekës [**turi**] kanë mbetur bosh. Në shkurt të vitit 2017, u dha miratimi ministror për themelimin e Fondacionit Kinostudio, [**dok. shtesë 5**] që do të zëvendësojë rolin e Orafilm, si garant i AFMM-së. [**dok. shtesë 43; 5**] AFMM-ja do të jetë institucion publik nën mbikëqyrjen e një komisioni të përhershëm. [**dok. shtesë 42**] Kjo do të sigurojë qëndrueshmëri më të madhe financiare për Akademinë, si dhe do të sigurojë përdorimin e godinës nga ana e saj. [M1; M2] Mungesa e pozicionit të Kancelarit ndikon në përputhshmërinë me **Kapitullin III Standardi I.2** (shihni gjithashtu pikën 1.1). [**Kapitulli III, Standardi I.2**]

1.3 AFMM-ja ka departamente në varësinë e Njesisë së Prodhimit, por nuk ka as Dekan të Fakultetit dhe as ndonjë lloj këshilli të fakultetit. [1] Stafi akademik përbëhet nga 4 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 pedagogë me kohë të pjesshme [GID], dhe si rrjedhojë, pritshmëria që secili departament të ketë të paktën shtatë anëtarë të stafit akademik nuk është përmbushur. Stafi me kohë të pjesshme, që përbëhet nga profesionistë të medias dhe filmit, sjell një përvojë të madhe në kurrikul [RVV fq.5; M2], por ata nuk kanë pasur trajnime në praktikën pedagogjike, edhe pse disa prej tyre japin mësim prej disa vitesh. Grupi i

Vlerësimi të Jashtëm e konsideron si **dobësi** mospërbushjen e Standardeve Shtetërore të Cilësisë lidhur me strukturat dhe stafin akademik, dhe **rekomandon** që Akademia të hartojë një plan për sigurimin e pasqyrimin të Standardeve Shtetërore të Cilësisë lidhur me strukturën, si dhe udhëheqjen e fakultetit dhe stafit të njësive të departamenteve në strukturën e saj drejtuese brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. **[Kapitulli III Standardi I.2, Kapitulli III Standardi II.1]**

1.4 Statutet e përshkruajnë Këshillin Akademik si “një organ kolegjal që vendos për programimin, koordinimin dhe kontrollin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe që vlerëson efikasitetin e tyre”. **[1]** Grupit të Vlerësimi të Jashtëm iu tha se Këshilli mbledhet afërsisht tre herë në vit, **[M2]** si dhe organizohen mbledhje shtesë, nëse nevojiten për menaxhimin e problemeve të sjelljes së studentëve. Procesverbalet që iu vunë në dispozicion Grupit të Vlerësimi të Jashtëm **[dok. Shtesë 44/1, 44/2]** ishin dëgjesa disiplinore lidhur me sjelljen e papërshtatshme të studentëve. Kryetari i Këshillit Akademik vëzhgon mësimdhënien e stafit **[M2]**, por nuk ka dokumente që vërtetojnë përdorimin e tyre nga Këshilli për të bërë vlerësimin e efikasitetit të veprimtarisë së mësimdhënies. Stafi i nivelit të lartë pohoi se **[M2]** kurrikula është miratuar nga Rektori dhe ndryshimet i janë raportuar Ministrisë. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk kishte fakte për përmbushjen e rolit të Këshillit Akademik, si qendra e debatit akademik për procesin e mësimdhënies, dhe doli në përfundimin se Këshilli Akademik nuk e ushtron rolin e tij kolegjal në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Kjo ndikon në përputhshmërinë me disa prej Standardeve Shtetërore të Cilësisë: ato që lidhen me debatin konstruktiv, që janë pjesë e **Standardit I.3** dhe **Standardit II.3 të Kapitullit III**, si dhe ato që lidhen me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës **Standardi I.4 i Kapitullit III**. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimi të Jashtëm e konsideron si **dobësi** faktin që Këshilli Akademik nuk e ushtron rolin e tij kolegjal në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies, dhe **rekomandon** që AFMM-ja duhet të sigurojë përmbushjen e rolit kolegjal të Këshillit Akademik në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies, të përcaktuar në Statute, brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. **[Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4 dhe Kapitulli III Standardi II.3]**

1.5 Ka një Strategji Zhvillimi, që është përgjegjësi e Rektorit dhe që menaxhohet nga Administratori. Me ndihmën e Ministrisë së Jashtme Franceze u hartua një plan fillestar, ku **[RVV fq.5]** më i fundit është ai i vitit 2014. **[dok. shtesë 0 dhe 6]** Rektori harton dhe monitoron planin, si dhe mbikëqyr menaxhimin e burimeve për të mundur zbatimin e tij **[1]**, por deri më tani nuk ka pasur asnjë ecuri. Në RVV **[RVV fq.21]** pohohet se kjo ndodh për shkak të problemeve që vijnë nga konkurrenca dhe presionet qeveritare. Plani i biznesit i vitit 2014 **[dok. shtesë 0 dhe 42]** përfshin qëllimin e hapjes së departamenteve të reja për aktrimin, prodhimin, zërin dhe efektet e veçanta/multimedial, **[dok. shtesë 0 dhe 42]** për të shtuar numrin e studentëve dhe për të dyfishuar të ardhurat deri në vitin 2019. Megjithatë, plani nuk përcakton se si do të mund të realizohen këto qëllime. Propozimi aktual është që të ketë vetëm tre departamente (prodhimi, zëri dhe aktrimi). **[dok. shtesë 6; M4]** Grupi i Vlerësimi të Jashtëm u informua se AFMM-ja dëshiron të shtojë numrin e studentëve me 10-12 studentë për vit, me qëllim përmirësimin e fleksibilitetit financiar **[M2]**, por nuk do të rekrutojë shumë, pasi kjo gjë mund të sjellë uljen e cilësisë së studentëve të pranuar. **[M5]** Nuk ka fakte për diskutimin e një gjëje të tillë, apo për monitorimin e planit brenda strukturës së Bordit, siç përcaktohet në **Kapitullin III Standardi I.5** të Standardeve Shtetërore të Cilësisë, si dhe plani nuk përfshin mënyrën e zbatimit të tij. Kjo gjetje mbështet dobësinë e identifikuar dhe rekomandimin e dhënë në pikën 1.6). **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

1.6 Sipas Statuteve secili departament përgatit planet e tij në konsultim me pedagogët, të cilat i paraqiten për miratim Rektorit **[1]**, por stafi i nivelit të lartë e informoi Grupin e Vlerësimi të Jashtëm **[M2]** se për këto zhvillime është rënë dakord me Administratorin, Rektorin dhe Kreun e Njësive së Prodhimit, dhe kostot janë vlerësuar nga Menaxheri i Financave, por faktet për diskutime të gjera mungojnë. Grupi i Vlerësimi të Jashtëm e

konsideron si **dobësi** faktin se planet nuk janë diskutuar gjerësisht, dhe as janë vlerësuar e monitoruar nga strukturat e Bordit dhe Këshillit, si dhe plani institucional nuk përfshin mënyrën e zbatimit të tij. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Akademia duhet të sigurojë diskutimin në shkallë të gjerë të planit ose strategjisë së zhvillimit dhe përfshirjen e mënyrës për të arritur rezultatet e propozuara brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. Kjo do të mbështesë përputhshmërinë me **Standardet I.3, I.4 dhe I.5 të Kapitullit III. [Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi I.5]**

1.7 Liria e shprehjes është e rëndësishme për stafin dhe studentët në zhvillimin e filmit. **[RVV fq.5]** Misioni i AFMM-së është të ofrojë arsimim dhe kualifikime profesionale, krijuese, artistike dhe teknike, ndërsa faqja e internetit nënvizon zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të reja lidhur me industrinë e filmit, për të mbështetur kapacitetin teknik dhe krijues në Shqipëri dhe Evropën Juglindore. **[faqja e internetit]** Prodhimi i filmave që trajtojnë tema lidhur me LGBT-në (lesbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinjorë) **[M1]** dhe të drejtat e njeriut **[M1; 11; turi në terren]** vërtetojnë angazhimin e stafit për lirinë e krijimit. AFMM-ja harton Raportin Vjetor rreth veprimtarisë së saj për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, i cili përfshin informacion për veprimtaritë kulturore që ajo ofron. **[dok. shtesë 6] [Kapitulli III Standardi II.1, Kapitulli III Standardi I.6]**

1.8 Nga përvoja profesionale dhe komunikimet me stafin profesional, si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme doli se njohuritë për industrinë e filmit dhe medias janë të mira, si dhe ofrohen mundësitë për punë. AFMM-ja mban lidhje me disa prej të diplomuarve të saj që punojnë në industri **[M6]**, si dhe ka partneritete me profesionistët e televizionit, filmit dhe medias. Shumë prej tyre punësojnë të diplomuar nga AFMM-ja dhe flasin pozitivisht për ta. **[M6]** Nuk ka të dhëna për punësimin e të diplomuarve të mëparshëm **[dok. shtesë 0; M2]** dhe si rrjedhojë mungon analiza e informacionit, që shërben si bazë për përgatitjen e kurrikulës. AFMM-ja ka marrë në konsideratë krijimin e një faqeje interneti, ku të diplomuarit të mund të përditësojnë të dhënat e tyre personale, por aktualisht nuk i ka burimet për këtë gjë. **[M2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** faktin që nuk ka të dhëna sistematike për punësimin e të diplomuarve, që sjell mungesën e analizës së tyre ku do të bazohet përgatitja e kurrikulës, dhe **rekomandon** që Akademia duhet të krijojë një proces sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve dhe të sigurojë se informacioni është përdorur për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri edhe një koment për këtë dobësi në Fushat e Vlerësimit 4 dhe 5, në pikat 4.3, 4.4 dhe 5.9. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.9 AFMM-ja ka lidhje me organizata ndërkombëtare, veçanërisht me CILECT (Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave të Filmit dhe Televizionit) **[RVV fq.3; M1; M2; M4]** Kjo gjë siguron akses në konferenca, workshop-e dhe festivale ndërkombëtare. Për shembull, një anëtar i stafit të AFMM-së ndoqi një konferencë me temën se çfarë nënkupton kërkimi në shkollat e filmit në kuadrin e procesit të Bolonjës. **[9]** AFMM-ja është anëtare e disa shoqatave ndërkombëtare të shkollave të filmit dhe e Konsorciumit Arsimor Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut. **[RVV fq.3]** Një projekt i BE-së, ku mori pjesë edhe AFMM-ja, i hapi rrugë 10 dokumentarëve për çështjet mjedisore **[23]** në festivalin e filmit mjedisor të vitit 2013 në Shqipëri. Stafi **[7; faqja e internetit]** ka kualifikime dhe përvojë nga shtete të tjera, përfshirë Gjermaninë, Republikën Çeke, Francën, SHBA-në dhe Rumaninë. Ka një listë mbresëlënëse të angazhimit të studentëve në festivalet e filmit në shtete si Gjermani, Bullgari, Uruguai, Greqi, Rumani, SHBA, Francë, Egjipt, Turqi dhe Itali. **[13]** Grupi identifikoi si **praktikë të mirë** lidhjet ndërkombëtare që kanë mundësuar organizimin e orëve të veçanta të specializuara dhe kontribute të tjera nga specialistë dhe profesionistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e prodhimit të filmave, qoftë fizikisht, apo edhe nëpërmjet videokonferencave, për përmirësimin e studimeve të studentëve dhe përvojës së tyre kulturore. Kjo gjetje mbështetet edhe nga pikat 5.3 dhe 5.8. **[Kapitulli III Standardi III.2,**

Kapitulli III Standardi III.3]

1.10 Një i diplomuar u ftua në një workshop ndërkombëtar për skenarin në Itali, **[8]** ndërsa një shkëmbim studentor në Gjermani rezultoi në bashkëprodhimin e një filmi në vitin 2012 **[10; RVV fq.6]**, me një shkollë partnere ndërkombëtare të filmit në Këln; **[11]** ndërsa në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Studentor të organizuar nga Bullgaria në vitin 2013 u përzgjodhën 6 filma **[9]** dhe dy studentë u ftuan në një festival të filmit shqiptar në prill të vitit 2017. **[9]** Dokumenti i Informacionit të Përgjithshëm (GID) i përgatitur për vlerësimin regjistron bashkëpunimin me dy IAL shqiptare dhe tre IAL të huaja. **[GID]** Është nënshkruar edhe një marrëveshje me Shkollën Helene të Kinemasë dhe Televizionit në Greqi. **[11]** AFMM-ja është anëtare e grupit evropian juglindor CILECT **[11]** dhe ka pasur mbështetje (financiare dhe materiale) nga ambasada amerikane për Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut. **[11]** Festivali i vitit 2017 përfshin një projekt që merret me të shkuarën e Shqipërisë, i cili është zhvilluar nga akademikë zviceranë duke punuar me studentët e AFMM-së. **[12]** Për të mbështetur studentët në shfrytëzimin e këtyre mundësive, mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe, angleze, franceze dhe italiane **[1]**, dhe aftësitë shumëgjuhësore të stafit dhe studentëve janë tejet mbresëlënëse. **[M1; M2; M3; M4; M5; M6]** **[Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3, Kapitulli III Standardi III.4]**

1.11 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm doli në përfundimin se ka dobësi në harmonizimin e proceseve dhe strukturave të drejtimit të AFMM-së me Statutet e saj dhe me Standardet Shtetërore të Cilësisë. Dobësitë lidhur me stafin dhe me strukturat e fakultetit dhe departamenteve rezultojnë pjesërisht nga numri i pakët i studentëve dhe të ardhurat e ulëta. Ndryshimet e fundit legjislative duhet të ofrojnë qëndrueshmëri më të madhe financiare, e cila do t'i mundësonte AFMM-së trajtimin e këtyre çështjeve. Ka dobësi në proceset për debatin akademik, veçanërisht për rolin e Këshillit Akademik, gjë që cenon debatin e në shkallë të gjerë lidhur me çështjet e zhvillimit akademik, cilësisë dhe planifikimit. Po ashtu, planet nuk përfshijnë mënyrën e realizimit të tyre. Nuk ka analizë të punësimit të të diplomuarve, megjithëse AFMM-ja komunikon me disa prej të diplomuarve të saj, disa prej të cilëve japin mësim në AFMM, ndërsa disa të tjerë punësojnë të diplomuar të tjerë të AFMM-së. Megjithatë, partneritetet ndërkombëtare dhe përvoja profesionale ndërkombëtare që stafi sjell në kurrikul dhe mësimdhënie konsiderohen si praktikë e mirë. Si rezultat i këtyre lidhjeve, studentët përfitojnë nga orët e veçanta të specializuara dhe kontributet e tjera nga personalitete ndërkombëtare në industrinë e filmit dhe medias.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet ndërkombëtare që kanë mundësuar organizimin e orëve të veçanta të specializuara dhe kontribute të tjera nga specialistë dhe profesionistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e prodhimit të filmave, qoftë fizikisht, apo nëpërmjet videokonferencave, për përmirësimin e studimeve të studentëve dhe përvojës së tyre kulturore (pikat 1.9, 5.3, dhe 5.8; **Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3, Kapitulli I Standardi III.8, Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e pozicionit të Kancelarit, që ndikon në funksionimin efikas të AFMM-së në përputhje me Statutet (pika 1.1; **Kapitulli III Standardi I.1, Kapitulli III Standardi I.2**)
- Standardet Shtetërore të Cilësisë lidhur me strukturat dhe stafin akademik nuk janë përmbushur (pika 1.3; **Kapitulli III Standardi I.2, Kapitulli III Standardi II.1**)
- Këshilli Akademik nuk ushtron rolin e tij kolegjal në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Kjo përbën debat konstruktiv dhe nënkupton se Akademia nuk mund të ushtrojë përgjegjësinë e saj për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës së saj siç përcaktohet në Statute (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi II.3**)
- planet nuk janë diskutuar gjerësisht apo monitoruar nga strukturat e Bordit dhe Këshillit, ndërsa plani institucional nuk përfshin mënyrat e zbatimit të tij (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi I.5**)
- nuk ka të dhëna sistematike për punësimin e të diplomuarve, që sjell mungesën e analizës së tyre ku bazohet përgatitja e kurrikulës (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi III.9**).
-

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- emërimin e një personi në rolin e Kancelarit për të siguruar pasqyrimin e Statuteve të tij në strukturën, brenda gjashtë muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.1; **Kapitulli III Standardi I.1, Kapitulli III Standardi I.2**)
- hartimin e një plani për sigurimin e pasqyrimin të Standardeve Shtetërore të Cilësisë lidhur me strukturën, si dhe udhëheqjen e fakultetit dhe stafit të njësive të departamenteve në strukturën e tij drejtuese brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.3; **Kapitulli III Standardi I.2, Kapitulli III Standardi II.1**)
- sigurimin e përmbushjes së rolit kolegjal të Këshillit Akademik në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies, të përcaktuar në Statute, brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi II.3**)
- sigurimin se Strategjia ose Plani i Zhvillimit janë diskutuar gjerësisht dhe përfshijnë mënyrën për arritjen e rezultateve të propozuara, brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.6; **Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi I.4, Kapitulli III Standardi I.5**)
- ndjekjen e një procesi sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, dhe sigurimin e përdorimit të informacionit për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës, brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit

përfundimtar (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli III Standardi III.1, Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi III.9**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 AFMM-ja kthen në prioritet emërimin e stafit akademik profesionist dhe të specializuar. Gjatë vitit akademik 2015/2016, u angazhuan 3 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 me kohë të pjesshme, prej të cilëve tre ishin pedagogë të huaj dhe dy nga diaspora (Kosova), [6 fq.4] ndërsa aktualisht janë angazhuar 2 pedagogë me kohë të plotë dhe 10 me kohë të pjesshme. [7] AFMM-ja ndjek një politikë të qartë lidhur me rekrutimin e stafit akademik me kohë të pjesshme dhe stafit mbështetës të mësimdhënies. E drejta e zgjedhjes së stafit buron nga autonomia e institucionit. [1, neni 6] Rekrutimi i stafit akademik ndërmerret në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 'Për arsimin e lartë të Republikën e Shqipërisë' [1, neni 6] dhe të strategjisë për rekrutimin e personave të njohur në fushën e medias dhe kinemasë. [M1 q.2; M5] Në këtë fushë të specializuar të studimit, rekrutimi i stafit profesionist akademik dhe të kërkimit është i vështirë, dhe shumica e pedagogëve të angazhuar nuk kanë tituj. [M1; M4] Rekrutohen kryesisht anëtarë stafi me kohë të pjesshme, ku përvoja profesionale në fushën e medias dhe kinemasë shërben si kriter bazë për përzgjedhjen. Modeli i përzgjedhjes për stafin me kohë të pjesshme është marrë nga institucione të ngjashme jashtë shtetit, për shembull nga shkollat e filmit në Francë, Gjermani dhe kudo ku profesionistëve iu ofrohen kontrata afatshkurtra. [M2; M4] Hartimi dhe nënshkrimi i kontratës për rekrutimin e stafit akademik është përgjegjësi e Rektorit. [1, Kapitulli. II, neni 10] Nuk ka komision të posaçëm rekrutimi, dhe stafi akademik nuk është angazhuar në këtë proces. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit nuk janë përcaktuar në rregulloret e brendshme të Akademisë. [2] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** mungesën e angazhimit të stafit akademik në procesin e rekrutimit të stafit dhe faktin se procesi nuk është dokumentuar plotësisht, dhe si rrjedhojë **rekomandon** që Akademia duhet të sigurojë përfshirjen e stafit akademik në procesin e rekrutimit të stafit dhe që vetë procesi të dokumentohet plotësisht brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. AFMM-ja i kushton rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit të huaj, veçanërisht nëpërmjet partneriteteve. [12; M1; M5] Stafi ndërkombëtar mund të angazhohet për periudha të shkurtra, zakonisht deri në 5 javë, si në rastin e projektit të mbështetur nga ambasada zvicerane. Përzgjedhja e stafit të tillë kryhet me marrëveshje të ndërsjellë me partnerët përkatës [M2 q6] (shihni gjithashtu pikat 1.9 dhe 1.10). [Kapitulli III, Standardi IV.1]

2.2 AFMM-ja është përqendruar në integrimin e stafit të saj. AFMM-ja ndjek politikën e ofrimit të ambienteve të duhura, përfshirë studiot, dhe sallat e leksioneve dhe seminareve për studentët dhe stafin e saj akademik. [M2; turi në terren] Pavarësisht punës së ndërmarrë që prej vitit 2004 për rinovimin e ambienteve ekzistuese, nevojiten investime të mëtejshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e godinës, për shembull në kinema. AFMM-ja ka siguruar pajisje të reja, disa nga partnerët, dhe disa si rezultat i projekteve të financuara. [M2; M4] AFMM-ja lehtëson pjesëmarrjen e stafit akademik në festivale, workshop-e dhe aktivitete të tjera të jashtme. [1 neni 13; 9.1; 9.2; 9.3] AFMM-ja iu ofron gjithashtu ish studentëve me aftësitë e përshtatshme mundësi për t'u punësuar në AFMM. Si shembull mund të merret rasti i një të diplomuari në vitin 2010 në Kamera dhe Montazh, i cili sot punon si inxhinier teknik. [RVV fq.8; M4] Megjithëse AFMM-ja nuk ofron programe të ciklit të dytë, të diplomuarit e saj mund të vazhdojnë me ndjekjen e programeve të Masterit në një tjetër shkollë dhe ndihmohen për të gjetur kurset e përshtatshme. Për shembull, një ish student po ndjek aktualisht programin e Masterit në Menaxhimin e Aktiviteteve Artistike në Beograd, Serbi. [RVV fq.8; M4] [Kapitulli III Standardi IV.2]

2.3 AFMM-ja nuk ndjek politikën e vlerësimit periodik të aftësive të stafit të saj, dhe madje, një politikë e tillë nuk parashikohet as në Rregulloret dhe as në udhëzimet e saj të veçanta institucionale. AFMM-ja nuk ka një strukturë për vëzhgimin periodik të mësimdhënies së stafit akademik [1.1; 1.2] megjithëse vëzhgimi kryhet disi nga kreu i pedagogjisë, si dhe diskutohet ndërmjet stafit për prodhimin e filmave. [M2] Stafi shprehu mendimin e tij se cilësia e prodhimit të filmave dëshmonte në vetvete cilësinë e

mësimdhënies, që tregonte mungesën e angazhimit me parimet e pedagogjisë. [M2] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti dokumente të raportit vjetor për mësimdhënien ose kërkimin e stafit, dhe as vlerësim sistematik në nivel institucional ose fakulteti. U ofruan fakte rreth fitimit të përvojës të stafit dhe studentëve në shtete të ndryshme nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe festivale [M4; M5; 9; 11; 13; 14], por nuk ka asnjë mekanizëm institucional për të ndarë me të tjerët praktikën e pjesëmarrjes në veprimtari të tilla. Deri në vitin 2008, AFMM-ja përdorte pyetësorët e studentëve për vlerësimin e aftësive të stafit të saj akademik [31], por aktualisht ajo nuk kryen asnjë formë vlerësimi bazuar në reagimet e studentëve. Studentët mund të shprehin mendimet e tyre dhe të ngrenë shqetësimet përmes diskutimeve, por jo në mënyrë anonime [M2 q.7], dhe si rrjedhojë disa prej tyre mendojnë se mendimet e tyre nuk merren parasysh. [M3 q.9, q.14] Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu tha se arsyeja për mosvlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe aftësive të stafit është numri i pakët i studentëve dhe nivelet e ulëta të përgjigjeve në pyetësorët e mëparshëm. [M2 q.7] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** mospërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme, për të mundësuar shprehjen e mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e AFMM-së. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Akademia duhet të ripërdorë pyetësorët për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmat e tjera të përshtatshme, për të mundësuar shprehjen e mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e tyre, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar. Kjo ndikon në përputhshmërinë me **Standardin IV.3 të Kapitullit III**, që është diskutuar edhe në pikën 4.3. [**Kapitulli III, Standardi IV.3**]

2.4 AFMM-ja ka një politikë efikase dhe të mirëpërcaktuar të zhvillimit social, dhe angazhohet në një sërë nismash sociale dhe kulturore, në bashkëpunim me shumë partnerë ndërkombëtarë nga universitete të ndryshme, si dhe me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu dhanë disa shembuj pjesëmarrjeje në disa festivale filmash [13] dhe shembuj bashkëpunimi me Institutin Italian të Kulturës, në prill të vitit 2011, për promovimin e kulturës së të dyja shteteve dhe mbështetjen e integritit të mëtejshëm të Shqipërisë në Evropë. Një nga veprimtaritë e qëndrueshme kulturore është shfaqja e filmave italianë përgjatë vitit akademik në aktivitetin 'E marta italiane'. [4] Një tjetër shembull është kontrata me delegacionin e BE-së në Tiranë për prodhimin e 10 dokumentarëve për çështjet mjedisore. [10] AFMM-ja ndjek politikën e sigurimeve shëndetësore sipas legjislacionit shqiptar. Studentët dhe stafi kanë sigurime të veçanta për periudhën kur udhëtojnë në terren për realizimin e filmimeve. [M2; tur në terren] [**Kapitulli III Standardi IV.4**]

2.5 E drejta e zgjedhjes së stafit buron nga autonomia e institucionit. [1 neni 6] AFMM-ja përcakton detyrat lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore. Funkcionet brenda AFMM-së përcaktohen në Statute dhe në rregulloret e brendshme. [**Kapitulli III, Standardi II.2**]

2.6 AFMM-ja është një institucion me vetëfinancim, pasi fondet sigurohen kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe përmes partnerëve ose projekteve. [1 neni 14] Buxheti është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me Udhëzimet e Ministrisë së Financave. Veprimtaria ekonomike e AFMM-së reflektohet në pasqyrën financiare vjetore, të përpiluar në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. [1 neni 15; M2 q.5] Rektori cakton kriteret për alokimin e fondeve. [1 neni 10, pika 3] Buxheti nuk ka natyrë pjesëmarrëse, pasi studentët dhe stafi akademik nuk përfshihen në diskutime për hartimin e tij. [M3 q.13] Nuk ka dokumente për prezantimin e detajuar të buxhetit të stafit akademik. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** mosdiskutimin e buxhetit me stafin dhe **rekomandon** sigurimin e diskutimit të buxhetit me stafin nga ana e Akademisë, nëpërmjet bordeve dhe këshillave, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar. Kjo do t'i mundësojë AFMM-së përputhshmërinë me **Standardin VI.1 të Kapitullit III**. [**Kapitulli**

III, Standardi VI.1]

2.7 AFMM-ja ndjek një politikë të qartë financiare. Fitimet bazë vijnë nga tarifat e studentëve, dhe projektet apo donacionet nga partnerët. **[M1; M2 q.6]** Politika financiare është gjithashtu e sanksionuar në Statut. Rektori është përgjegjës për hartimin e planit financiar dhe alokimin e të ardhurave nga strukturat përkatëse. **[M1; M2; neni 10, pika 3]** Kancelari është personi përgjegjës për zbatimin e buxhetit, si dhe mbikëqyrjen dhe kontrollin e transaksioneve financiare sipas ligjit të zbatueshëm. **[Neni 10 i Statutit; M2]** Aktualisht AFMM-ja nuk ka Kancelar dhe roli i tij kryhet nga Administratori, që në fakt është dobësi e identifikuar në pikat 1.1 dhe 1.2. **[M2]** Përgjegjësi i financës mban dokumentet e të gjitha transaksioneve të AFMM-së, vlerëson bilancet mujore dhe vjetore, kryen transaksionet e shpenzimeve të AFMM-së nëpërmjet bankës dhe paguan detyrimet e AFMM-së te autoritetet e taksave. **[1 neni 10]** Përgjegjësi i financës është emëruar vetëm dy muaj përpara kryerjes së vlerësimit të jashtëm. **[M2]** AFMM-ja zbaton të gjitha politikat financiare të parashikuara në legjislacionin shqiptar. **[dok. shtesë 43] [Kapitulli III Standardi VI.2]**

2.8 AFMM-ja siguron të gjitha mjetet e nevojshme për të zbatuar politikat e saj financiare. **[1 neni 15; M2]** Politika financiare mbështetet në kuadrin ligjor. **[Ligji nr. 9741 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë', datë 21.05.2007; Ligji nr. 9720 'Për auditimin e brendshëm në sektorin publik', datë 23.04.2007]** Për sa u përket angazhimeve ndërkombëtare të projektit, raportet financiare i nënshtrohen auditimit nga autoriteti financiar përkatës, ndërsa **[M1]** vetë Akademia i nënshtrohet auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. **[RVV fq.9] [Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.9 AFMM-ja ka një sistem informacioni të koordinuar, dhe informacioni shpërndahet ose në format të shtypur ose në format elektronik. AFMM-ja ka faqen e saj të internetit www.afmm.edu.al në gjuhën angleze, ku publikon të gjitha informacionet lidhur me programin, procedurat e regjistrimit, projektet, veprimtaritë dhe partneritetet. Shkolla ka një email zyrtar, një adresë gmail dhe një buletin informativ elektronik. Këndi i njoftimeve në katin e parë përdoret për njoftimin e studentëve lidhur me veprimtaritë e tyre javore, orët mësimore dhe angazhimet e tjera studimore. **[turi në terren]** Informacioni i nevojshëm lidhur me studimet e studentëve shpërndahet përmes fletëpalosjeve dhe broshurave. **RVV fq.10; M4 q9] [Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.10 AFMM-ja koordinon veprimtaritë në fushën e teknologjisë. Pjesa më e madhe e pajisjeve në studio janë të digjitalizuara. Biblioteka vë në dispozicion të studentëve 12 kompjuterë të lidhur me internetin. Ka edhe një klasë me pajisjet e nevojshme për videokonferenca. Biblioteka ofron gjithashtu një sallë të veçantë për videokonferenca. Zyrat dhe sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjutera. **[turi në terren; RVV fq.11]** Komunikimi nga administratori dhe stafi akademik bëhet nëpërmjet këndit të njoftimeve, të vendosur përballë hyrjes kryesore në katin e parë, si edhe nëpërmjet emailit. **[turi në terren; M3]** Pavarësisht përpjekjeve të AFMM-së, më shumë vëmendje i duhet kushtuar kompjuterizimit të sistemit administrativ. Studentët nuk kanë akses online për t'u regjistruar për provime, por administrimi i numrit relativisht të ulët të studentëve është efikas. Sekretarja mban të dhënat e studentëve, së bashku me rezultatet në format të shtypur **[turi në terren]** dhe në një fletë të dhënash elektronike. **[20] [Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.11 AFMM-ja zotëron dokumentet e pronës ku është vendosur. **[19]** Prona e AFMM-së është në pronësi të shtetit, dhe prona e paluajtshme sigurohet nga ligji për kinematografinë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës. **[M1 q8]** Plani i sigurisë është subjekt rishikimi vjetor nga autoritetet përkatëse dhe paraqitet në hyrjen e godinës. **[vizitë në terren]** AFMM-ja ka një plan të qartë për pronësinë e pronës së saj, të siguruar për një periudhë afatgjatë. Plani i biznesit për vitin 2014 parashikon se "prona e përdorur përgjatë viteve do të konsiderohet si pronë e Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi, dhe askush nuk do të ketë të drejtën ta privatizojë atë". Kjo gjë pasqyrohet edhe në planin e biznesit për hapjen e

departamenteve të reja. **[dok. shtesë Plani i biznesit i vitit 2014]** AFMM-ja është subjekt inspektimesh periodike për mbrojtjen nga zjarri dhe ka një skemë evakuimi. **[19] [Kapitulli III Standardi VII.3]**

2.12 AFMM-ja ka një arkiv në katin e dytë për ruajtjen e të gjithë filmave të studentëve që prej vitit 2004. Në të ardhmen, theksi do të vihet te digjitalizimi i arkivit. **[vizitë në terren]** Punimet e studentëve mbahen të dokumentuara në zyrën administrative. Secili student që është regjistruar ose diplomuar ka dosjen e tij/saj individuale. Të dhënat bazë të regjistrimit, vlerësimet përkatëse, teza e diplomimit dhe informacione të tjera ruhen përgjatë gjithë periudhës së studimit të studentëve dhe madje edhe pas saj. **[vizitë në terren] [Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.13 AFMM-ja ka strukturë administrative të mirëkrijuar që iu mundëson departamenteve të kryejnë funksionet e interesit të përbashkët. AFMM-ja zotëron infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur kërkesat për ofrimin e mësimdhënies **[tur në terren; 19]** dhe ofron ambientet për të përmbushur nevojat e 12 pedagogëve aktualë. **[7]** Janë bërë përpjekje për ofrimin e kushteve të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara. Në hyrje të godinës është ndërtuar një rampë me fonde nga partnerët e huaj për lehtësimin e pjesëmarrjes së studentëve dhe personave të tjerë me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore, të organizuara në kopshtin e AFMM-së. **[tur në terren; M4]** Dyshemeja e kinemasë është përgjithësisht e rrafshët, por disa salla kanë një shkallë të vogël në hapësirën e derës, e cila mund të jetë problematike për këdo që ka probleme me lëvizjen ose që përdor karrige me rrota, dhe si rrjedhojë lehtësirat për studentët me aftësi të kufizuara nuk janë plotësisht funksionale, edhe pse AFMM-ja aktualisht nuk ka të regjistruar studentë me aftësi të kufizuara. **[M4; tur në terren]** Klasat e AFMM-së nuk janë të mbipopulluara falë numrit të pakët të studentëve. AFMM-ja ka politikë të qartë për të mos shtuar në mënyrë të ndjeshme numrin e studentëve të saj, dhe për këtë arsye infrastruktura është plotësisht e përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të cilësisë për procesin e mësimdhënies. **[M1; M2] [Kapitulli III Standardi VII.5]**

2.14 AFMM-ja ka strukturë administrative të mirëkrijuar për mbështetjen e procesit të mësimdhënies. Strukturat organizative janë krijuar në përputhje me Statutet e AFMM-së. **[M1, M4 dhe neni 10 i Statutit]** AFMM-ja ka në pronësi dy mjete dhe merr me qira mjete të tjera transporti dhe pajisje për të lehtësuar punën e studentëve gjatë projekteve të kursit, veçanërisht gjatë xhirimeve të filmave. Rregulloret përfshijnë udhëzime bazë për sigurinë. **[2; 3; RVV fq.11; tur në terren][Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.15 AFMM-ja ka strukturë të përshtatshme për mësimdhënien. **[dok. 19]** Godina u rinovua në vitin 2004 nga Orafilm në bashkëpunim me UNESCO-n. Sipërfaqja totale është 3,906.5 m². **[19; turi i vizitës; M1; RVV fq.11]** Rreth 1575m² e sipërfaqes zihet nga klasat për orët teorike. Një klasë shërben gjithashtu për videokonferenca. Brenda godinës ndodhen tre studio, një punishte dhe dy salla shfaqjesh (njëra kryesore, dhe tjetra më e vogël), katër zyra për administratën, një sallë për pedagogët, një arkiv dhe një bibliotekë. Vetë biblioteka ka tre ambiente: një sallë leximi ose sallë kompjuterash ku ndodhen 12 kompjutera, një sallë videosh ku janë arkivuar një numër i madh videosh, dhe një sallë për videokonferenca që shpesh shërben si klasë ku pedagogët mund të ilustrojnë shembujt e marrë nga libra ose filma të ndryshëm, që mund të aksesohen lehtësisht nga biblioteka ose arkivi i videove. Një sallë e veçantë përmban arkivat dhe një sallë tjetër është e posaçme për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut (IHRFFA) ose për veprimtari të tjera kulturore. Këshilli Studentor nuk ka sallë të posaçme mbledhjesh, megjithëse njëra prej klasave po përdoret për këtë qëllim. **[tur në terren]** AFMM-ja zotëron një ambient të jashtëm të pajisur me sistem ndriçimi dhe hapësira për veprimtari sociale dhe kulturore, si dhe për festivale filmi. Parkimi është i mjaftueshëm për numrin e studentëve dhe stafit. Infrastruktura është e siguruar nga një sistem evakuimi në rast zjarri. **[19; 16]** Ambientet janë të pajisura me kondicionerë dhe ka hapësira dhe mjedise argëtimi të përshtatshme për studentët

brenda dhe jashtë ndërtesës. Sallat janë të ndriçuara mirë, si dhe kanë edhe dritare. **[vizitë në terren] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.16 AFMM-ja ka ngritur dhe mirëmban sistemet e përshtatshme për menaxhimin efikas të kërkesave të dokumentacionit në format të shtypur dhe elektronik. Sistemi menaxhohet dhe drejtohet nga Administratori që është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit të studentëve dhe stafit. **[1, neni 10]** Sekretaria, që menaxhohet nga administratori, është përgjegjëse për ruajtjen e të gjithë dokumentacionit të studentëve, duke përfshirë materialet e tyre të vlerësimit. Informacioni mbahet në format të shtypur. Dosjet e studentëve ruhen në raftet, ku identifikohen nëpërmjet emrit dhe fotografisë. **[tur në terren]** Secila dosje përmban të gjithë dokumentacionin e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre, duke përfshirë punimet për çdo modul, si dhe punimin e diplomës **[tur në terren; RVV fq.12]**. Dosjet e ish-studentëve mbahen në një vend të posaçëm në zyrë. Sekretariati i mban të dhënat bazë, si numrat e identifikimit të studentëve dhe kualifikimet e amzës në format elektronik. **[20] [Kapitulli III Standardi V.2]**

2.17 E drejta e AFMM-së për të zgjedhur stafin akademik buron nga Statutet dhe synon të rekrutojë staf akademik me kohë të pjesshme. Kriteri kryesor është përvoja e tyre në fushën e medias dhe filmave, dhe prioritet kanë ata me përvojë jashtë shtetit. Megjithatë, AFMM-ja nuk ka një politikë të qartë për rekrutimin, pasi ky procesi nuk parashikohet në Rregulloret institucionale. AFMM-ja nuk ka ngritur asnjë komision të posaçëm për vlerësimin e kandidatëve, ndërsa stafi akademik nuk është përfshirë në këtë proces. Nuk ka proces zyrtar për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies së ofruar, dhe pyetësorët e studentëve nuk janë përdorur për vlerësimin e stafit. Integrimi i stafit akademik me studentët, që është vënë në qendër të vëmendjes, arrihet përmes programeve të studimit dhe veprimtarive të tjera kulturore. AFMM-ja ka bërë disa përmirësime në infrastrukturë, megjithëse të kufizuara për shkak të mungesës së burimeve. Shumë prej pajisjeve më të fundit për mbështetjen e procesit të mësimdhënies janë siguruar nëpërmjet projekteve dhe partneriteteve. Politika financiare e Akademisë mbështetet në një kuadër ligjor të përshtatshëm dhe të mirëpërcaktuar. Megjithatë, procesi i përgatitjes së buxhetit nuk ka natyrë pjesëmarrëse, pasi studentët dhe stafi akademik janë përjashtuar prej tij. AFMM-ja ka një sistem informacioni të koordinuar, dhe informacioni shpërndahet ose në format të shtypur ose në format elektronik.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e angazhimit të stafit akademik në procesin e rekrutimit të stafit, dhe mosdokumentimin e plotë të tij (pika 2.1; **Kapitulli III Standardi IV.1**)
- mospërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme për mundësimin e shprehjes së mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e AFMM-së (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli III Standardi IV.3, Kapitulli I Standardi II.3**)
- mungesa e përfshirjes së stafit në diskutimet për hartimin e buxhetit (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VI.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- sigurimin se stafi akademik përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit dhe se vetë procesi dokumentohet plotësisht, brenda 6 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 2.1; **Kapitulli III Standardi IV.1**)
- ripërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme për mundësimin e shprehjes së mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e tyre, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli III Standardi IV.3, Kapitulli I Standardi II.3**)
- sigurimin se buxheti është diskutuar me stafin në bordet dhe këshillat e duhura, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VI.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Akademia u themelua në vitin 2004 me misionin e ofrimit të arsimit të lartë profesional në teorinë dhe praktikën e prodhimit të filmave, televizionit dhe formave të tjera të prodhimit të multimedias. **[Faqja e internetit; 1; 20.2; 20.3]** AFMM-ja ofron një program studimi trevjeçar me kohë të plotë, në fund të të cilit studentët marrin diplomë Bachelor (diplomë e ciklit të parë), që zhvillohet nga stafi me kohë të pjesshme, të cilët praktikojnë edhe prodhimin e filmave. Programi i diplomës përfshin module përmes së cilave grumbullohen 180 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) për tre vite. **[1; 2; 21]** Programi u akreditua për herë të parë me Urdhrin nr. 227 (26.05.2008) të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. **[dok. shitesë 6]** AFMM-ja është i vetmi institucion i arsimit të lartë për filmin dhe multimedian në Shqipëri dhe është anëtare aktive me të drejta të plota e CILECT (Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave të Filmit dhe Televizionit), shoqatë ndërkombëtare e shkollave të filmit. **[40]** Akademia përqendrohet veçanërisht në trajnimin e studentëve në fushat bazë të prodhimit të filmave dhe multimedias, dhe veçanërisht në zhvillimin e aftësive të specializuara në fushën e regjisorës, montazhit, kameras dhe skenarit. **[1; M2 fq.9]** Gjatë vlerësimit të jashtëm, Akademia kishte plane për kapacitete shtesë për ofrimin e specializimeve të mëtejshme në fushën e prodhimit, zërit dhe aktrimit. **[dok. shitesë 42; M7]** Programi i ofruar nga Akademia përshkruhet qartë në faqen e saj të internetit, si dhe publikohet në panairin e studentëve. **[Faqja e internetit; RVV]** Procedurat e pranimeve janë përcaktuar në faqen e internetit dhe Rregullore, dhe përfshijnë një intervistë përzgjedhëse, detyrë me shkrim dhe vlerësim të punimeve të mëparshme nga një panel prej tre anëtarësh. Akademia përdor sistemin kombëtar të aplikimit online. **[M7]** Kualifikimi minimal hyrës është diploma e shkollës së mesme (Matura Shtetërore) ose një diplomë ndërkombëtare ekuivalente sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[2]** Metodot dhe kriteret për vlerësimin e studentëve janë përcaktuar në Rregullore dhe në dokumentacionin e modulit, dhe përfshijnë provimet me shkrim dhe vlerësimin e filmave të prodhuar nga studentët. **[RVV; 2][Kapitulli I Standardi I.1]**

3.2 AFMM-ja nuk ofron programe ose kurse me kohë të pjesshme ose afatshkurtra. Në RVV dhe në mbledhjet me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm u theksua se integrimi i ofrimit të programeve me kohë të pjesshme me natyrën kumulative të kurrikulës do të ishte i vështirë, dhe ofrimi i programeve afatshkurtra do t'i tejkalohe burimet aktuale të stafit të Akademisë. **[RVV; M1; M2]** Megjithatë, Akademia nuk ofron një kalendar vjetor të aktiviteteve, ku përfshihen workshop-e, shfaqje filmash, festivale, mbrëmje muzikore dhe poetike, që ndiqen si nga ish studentët, ashtu edhe nga publiku. Në vitin 2016, këtu përfshihej edhe edicioni i 11-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. **[RVV; 12; 22; dok. shitesë 6]** AFMM-ja ofron gjithashtu seanca të veçanta mësimore çdo vit, të organizuara nga prodhuesit ndërkombëtarë vizitorë të filmave, të cilët janë me dhjetëra, ose edhe më shumë. **[6; 16]** Akademia njehtë përvojën ose kualifikimet e mëparshme, por kjo kufizohet përgjithësisht vetëm te studentët që kanë ndjekur shkollat e filmit të CILECT. **[M2]** Ashtu siç parashikohej, ky Standard është përbushur deri më tani. **[Kapitulli I Standardi I.2]**

3.3 Strategjia e zhvillimit të Akademisë është përcaktuar në mënyrë efikase si në planin vjetor të biznesit, dhe në raportin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe në të dyja rastet këto dokumente vlerësojnë arritjen e objektivave. **[6; 42; M1]** Oferta akademike e Akademisë është në përputhje me këto plane, me stafin në dispozicion dhe burimet materiale. **[21; M2]**. Diploma dhe suplementet e saj të lëshuara nga Akademia përcaktojnë fushat akademike dhe të praktikës ku janë trajnuar dhe kualifikuar të diplomuarit, si dhe janë në përputhje me standardet ESG të certifikimit. **[23; 25]** **[Kapitulli I Standardi I.3]**

3.4 Akademia ofron një program të vetëm, që është i mirëstrukturuar dhe iu lejon studentëve të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënyrë progresive gjatë tre viteve të

programit. Arsimimi lidhur me prodhimin e filmave i ofruar nga AFMM-ja është plotësisht në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, veçanërisht nëpërmjet anëtarësimit të saj në CILECT, dhe dorëzimit të punimeve të studentëve në festivalet ndërkombëtare konkurruese. **[6; 8; 10; 11; 12; 13; 14; M5]** Akademia përfshin specialistë të huaj në panelet që vlerësojnë filmat e studentëve. **[M5]** Për shkak të karakterit ndërkombëtar të prodhimit të filmave, të paktën 20 për qind e punimeve të studentëve janë në gjuhën angleze, veçanërisht orët e veçanta mësimore të ofruara nga profesionistët e huaj. Kjo gjetje mbështet praktikën e mirë të identifikuar në pikën 1.9. **[RVV]** Diploma dhe suplementet e saj të lëshuara nga Akademia janë në përputhje me kuadrin e kualifikimeve të Bolonjës dhe përcaktojnë kreditet ECTS të grumbulluara nga studentët e diplomuar. **[23; 25] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.5 Raporti studentë/pedagogë është i ulët. Në vitin 2016, ky raport ishte 2.72 studentë për çdo pedagog. Megjithatë, duke qenë se pjesa më e madhe e stafit janë me kohë të pjesshme, raporti pedagog me kohë të plotë/ studentë është afërsisht 11:1. **[6]** Mësimdhënia financohet tërësisht nga tarifat e paguara nga Akademia. **[1]** Kostot e pajisjeve dhe materialeve për studentë janë të larta dhe subvencionohen nëpërmjet ofrimit të pajisjeve dhe fondeve nga jashtë vendit, si British Council dhe Ambasada e Zvicrës. **[6; M1; M7]** Ngarkesa mësimore e anëtarëve të stafit varet nga kontratat e tyre, që përcaktohen nga Rektori dhe që janë kryesisht për punësim me kohë të pjesshme. **[1; M1; M2]** Programi mësimor i çdo viti është planifikuar nga Administratori i AFMM-së në bashkëpunim me Rektoren. **[dok. 1]** Stafit akademik nuk i është kërkuar të ndërmarrin kërkime akademike apo të botojnë. Përkundrazi, prej tyre pritet të japin prova të praktikës së vazhdueshme të nivelit të lartë në shumë aspekte të filmit dhe medias, që zhvillohen në Akademi. **[RVV; 7; M1] [Kapitulli I Standardi I.5]**

3.6 Përshkrimet e programit të studimit dhe lëndët individuale (modulet) e përfshira në secilin vit studimi janë të disponueshme në faqen e internetit të AFMM-së dhe iu vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo vitit akademik. **[Faqja e internetit; 21; 24; M4]** Hollësitë për datat e të gjitha orëve mësimore dhe dorëzimin e vlerësimit janë paraqitur në këndin e njoftimeve të Akademisë, ndërsa programet e pjesëmarrjes dhe punëve që duhen ndjekur nga studentët përditësohen çdo javë. **[M2; M4]** Plani i detajuar i objektivave dhe përmbajtjes së kursit, si dhe mënyrat e vlerësimit të tyre janë përcaktuar në Kapitujt III dhe IV të Rregulloreve të Akademisë. **[2]** Studentët e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohuan se e kuptojnë përmbajtjen e programit dhe atë çka iu kërkohet për të pasur sukses. **[M4]** Kriteret dhe procedurat e pranimit në Akademi janë përcaktuar në faqen e internetit dhe në nenet 21 dhe 22 të Statuteve. **[1] [Kapitulli I Standardi I.6]**

3.7 Programi i ciklit të parë të studimit i ofruar nga Akademia parashikon sigurimin e zhvillimit rritës të njohurive teorike dhe aftësive praktike për median nga ana e studentëve. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, puna teorike dhe praktike, prodhimi dhe paraqitja e punimeve të studentëve. **[2; 6; M1; M4; M5]** Orët mësimore ndahen në orë që trajtojnë teorinë, prodhimin dhe aftësitë për median. **[2; 21]** Neni 10 i Rregullores parashikon procedurat për transferimin në institucione të tjera ose në programe studimore pasuniversitare, ndërsa Akademia ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për transferim me një sërë institucionesh të tjera që ofrojnë mësimdhënie për prodhimin e filmave dhe median. **[2]** Për zhvillimin e programit të studimit përdoren komponentë modularë dhe të ECTS-së, ndërsa suplementet e diplomës që iu jepen të diplomuarve përcaktojnë qartë kurset që ata kanë ndjekur. **[25]** Një ndër objektivat themelore të programit të studimit është përvetësimi i njohurive dhe aftësive nga ana e studentëve, që do t'i mundësojnë punësimin në industrinë e filmit dhe medias në Shqipëri dhe shtete të tjera. **[1; 21; M1]** Akademia ruan dhe përditëson dosjet, duke detajuar karrierën e ardhshme të të diplomuarve të saj. **[6; M2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi një grup punëdhënësish dhe personalitete të rëndësishme të industrisë shqiptare të filmit dhe medias, që pohuan se studentët e AFMM-së të punësuar prej tyre kanë pasur përgatitjen e duhur për të hyrë në këtë industri. **[M6]**

[Kapitulli I Standardi I.7]

3.8 Për sa i përket mbështetjes për orientimin e studentëve dhe ecurinë e tyre, karakteristikë kryesore e AFMM-së është numri i paketë i studentëve. Gjatë kryerjes së vizitës së vlerësimit të jashtëm, ishin regjistruar vetëm 15 studentë. Kjo nënkupton se studentët marrin vëmendje personale dhe të individualizuar nga administrata dhe stafi i mësimdhënies. **[M2; M4; M5]** Kurrikula përcakton kritere të qarta për përparimin. Studentët nuk mund të përparojnë nga njëri vit në tjetrin pa kaluar vlerësimet e nevojshme, si dhe pa dorëzuar numrin e kërkuar të punëve praktike (filma) dhe pa demonstruar aftësitë e nevojshme. **[1; 2; 3; 21; M1; M2; M4; M5]** Pjesa më e madhe e stafit të mësimdhënies janë profesionistë me kohë të pjesshme, që janë punësuar për shkak të aftësive të tyre aktuale lidhur me teorinë dhe praktikën e prodhimit të filmave. Krahas estetikës së mësimdhënies së stafit, kërkimi akademik standard dhe të dhënat për publikime nuk janë pjesë e rëndësishme e kërkesave të stafit të mësimdhënies me kohë të pjesshme. **[M2; M6]** Nuk është e përshtatshme në aspektin pedagogjik dhe as e realizueshme në aspektin financiar që 70 për qind e stafit të mësimdhënies të ciklit të parë të jetë me kohë të plotë. Ata duhet të jenë pedagogë që aktualisht praktikohen në industrinë e filmit dhe medias. **[6; M1; M5; M6]** Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se do të ishte e dobishme që, stafi akademik me kohë të pjesshme, të kishte më shumë akses për t'u mbështetur në teknikat e mësimdhënies dhe mësimdhënies, dhe njohuritë më të fundit të pedagogjisë në arsimin e lartë. **[M4; M5]** Në lidhje me **Standardin I.8 të Kapitullit I**, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi si **dobësi** mungesën e një anëtari me kohë të plotë të stafit akademik për të ofruar udhëheqje pedagogjike në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe udhëzime akademike të pavarura për studentët. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Akademia të shtojë në stafin e saj me kohë të plotë një akademik me përvojë dhe formim në teori dhe praktikë për arsimin e lartë, i cili të mund të këshillojë stafin me kohë të pjesshme për metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, dhe të ofrojë udhëzime akademike të pavarura për studentët brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. **[Kapitulli I Standardi I.8]**

3.9 AFMM-ja nuk ofron programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë **[1;3; 6]** dhe si rrjedhojë **Standardi I.9** i **Kapitullit I** nuk zbatohet. **[Kapitulli I Standardi I.9]**

3.10 Për zhvillimin e programit të studimit përdoren komponentë modularë dhe të ECTS-së, ndërsa suplementet e diplomës që iu jepen të diplomuarve përcaktojnë qartë kurset që studentët kanë ndjekur dhe kreditet dhe notat që ata kanë marrë. **[25]** Një ndër objektivat themelore të programit të studimit është përvetësimi i njohurive dhe aftësive nga ana e studentëve, që do iu mundësojnë punësimin në industrinë e filmit dhe medias në Shqipëri dhe shtete të tjera. **[1; 21; M1]** AFMM-ja pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme të programit (viti i parë dhe i dytë) nga universitete të tjera, institucione arsimore ose fakultete që e ushtrojnë veprimtarinë në fushën artistike dhe kulturore. **[1]** Studentët në hyrje duhet të mbledhin kreditet dhe të shënojnë arritje në fusha që përkojnë me kurrikulën e AFMM-së. Akademia ka një përvojë ose kualifikimet e mëparshme, por kjo është e kufizuar për studentët që kanë ndjekur shkollat e filmit të CILECT. **[M2]** Akademia ka pranuar studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbi (Preshevë-Medvegje dhe Bujanovc). **[6]** **[Kapitulli I Standardi I.10]**

3.11 Programi i studimit i ofruar nga AFMM-ja është parashikuar të integrojë studimin teorik dhe akademik të estetikës me praktikën e prodhimit të filmave. Elementet teorike të programit mësohen përgjithësisht në semestrin e parë të secilit vit dhe përkthehen në punë praktike në semestrin e dytë. **[RVV; 3; 21]** Gjatë vlerësimit të jashtëm doli në pah se 19 prej studentëve që i kishin përfunduar me sukses elementet praktike të programit të studimit nuk e kishin marrë diplomën, pasi duhej të përfundonin elementet teorike. **[dok. 6]** Ndjekja dhe pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, si festivale dhe konkurse filmash janë pjesë përbërëse e përvojës në AFMM. Akademia organizon gjithashtu shumë shfaqje,

leksione dhe aktivitete të tjera kulturore që ndiqen nga publiku dhe alumni, në të cilat studentët aktualë luajnë pjesë kryesore. **[6; M1; M4; M5] [Kapitulli I Standardi I.11]**

3.12 AFMM-ja ruan dosjet personale me dokumente të të gjithë të diplomuarve në të shkuarën, që përmbajnë informacione për punësimin e tyre aktual. Akademia synon punësimin e pothuajse 100 për qind të të diplomuarve të saj në industritë përkatëse të medias brenda dhe jashtë vendit **[6; M1; M2; M6]**, por rreth kësaj çështjeje nuk ka të dhëna sistematike (shihni gjithashtu pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9). Aftësitë praktike në prodhimin e filmave që mësohen nga AFMM-ja zbatohen në nivel ndërkombëtar. **[M6]** Si pjesë e formimit të tyre, studentët mësojnë aftësitë e biznesit dhe financimit nëpërmjet përvojës së marrjes së mbështetjes dhe burimeve për filmat që u kërkohen të realizojnë. **[21; 25]** Megjithatë, Akademia i tregoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se kur burimet e lejonin, synohej prezantimi i programeve më specifike në fushën e prodhimit të filmave (që do të thotë, aftësi në biznes dhe aspektet financiare të prodhimit të filmave). **[M2] [Kapitulli I Standardi I.12]**

3.13 Kurrikula e ciklit të parë e ofruar nga AFMM-ja është unike në Shqipëri, lidhur me ndërthurjen e arsimit, teorisë, dhe estetikës së filmit me trajnimin gjithëpërfshirës në aftësitë praktike të prodhimit të filmave. Ky arsimim dhe trajnim kërkon nivel të lartë angazhimi dhe aftësie nga ana e studentëve, dhe mbështetet për mësimdhënien nga stafi që zhvillon praktikën dhe që është i përditësuar me kërkesat artistike dhe teknike gjithnjë në ndryshim të industrisë së filmit dhe medias. Suksesi i AFMM-së në arritjen e qëllimeve të kurrikulës së saj dëshmohet nga punësimi i të diplomuarve të saj në industrinë e medias, brenda dhe jashtë vendit. Gjatë kryerjes së vizitës së vlerësimit të jashtëm, në AFMM ishin regjistruar vetëm 15 studentë në të tria vitet e programit të saj të vetëm. Pavarësisht mundësisht të mbështetjes intensive dhe individuale të studentëve për shkak të numrit të ulët, nënkuptohet se burimet për mbështetjen e punësimit të stafit me kohë të plotë me formim në fushën e pedagogjisë, si dhe menaxhimit të cilësisë dhe standardeve në arsimin e lartë janë të papërshtatshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pati kënaqësinë rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në vitin e parë të programit për vitin akademik 2016-2017, gjë që lejon rritjen e rekrutimit të pedagogëve me kohë të plotë, por ka dhënë edhe një rekomandim për këtë fushë.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një anëtari me kohë të plotë të stafit akademik për ofrimin e udhëheqjes pedagogjike në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe udhëzimeve akademike të pavarura për studentët (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi 1,8**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- shtimin e një akademiku me përvojë dhe formim në teori dhe praktikë për arsimin e lartë në stafin e tij me kohë të plotë, i cili të mund të këshillojë stafin me kohë të pjeshme rreth metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe të ofrojë udhëzime akademike të pavarura për studentët brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 3.8; **Kapitulli I Standardi 1.8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 AFMM-ja ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve të studimit. Struktura e kurrikulës paraqitet në Statute dhe në Rregullat e Procedurës së Akademisë. **[1; 2]** Në fillim të vitit të parë, studentët njihen me listën e kurseve. **[3]** Në vitin e parë, raporti i orëve mësimore është 50 për qind prodhim artistik dhe teori e praktikë e specializuar, dhe 50 për qind përgatitje teorike e përgjithshme. Në vitin e dytë, raporti i orëve mësimore është 60:40, ndërsa në vitin e tretë, raporti i orëve mësimore është 75:25. **[2 kapitulli 1, nenet 11 - 15]** Përgjatë 12 viteve, kurrikula ka pësuar ndryshime. Ndryshimet në përmbajtje kanë ardhur si rezultat i përvojës së stafit, nga ndryshimet në shoqëri dhe ndryshimet në profesion. Ndryshimet në përmbajtjen e moduleve kanë ardhur gjithashtu si rezultat i marrëveshjes së Bolonjës. Ndryshimet në program synojnë të trajtojnë objektivin e Akademisë si një vend ku zhvillimi profesional është prioritet madhor. **[M5 q1]** Ndryshimi kryesor ka qenë pakësimi i mësimdhënies së teorisë në favor të aftësive të prodhimit. Gjithashtu, ndryshimet kanë pasqyruar praktikën e institucioneve të huaja. Pedagogët me përvojë në Paris apo diku tjetër i kanë përvetësuar këto qasje gjatë zhvillimit të teorisë dhe praktikës. **[M5]** Përgjegjësit e Departamentit dhe Njesisë së Prodhimit janë përgjegjës për zbatimin e mësimdhënies në fushat e tyre të specializimit. **[M2 ; M3]** Pedagogët monitorojnë praktikën në lëndët e tyre përkatëse, si dhe janë pjesë e vlerësimit të punës së studentëve dhe diskutojnë dhe vendosin për temat e projekteve përpara se t'ua mësojnë studentëve. **[M5 q13]** AFMM-ja vë në dispozicion mjetet, studiot dhe pajisjet për mësimdhënien dhe mësimnxënien. **[vizitë në terren; M4; M5]** *[Kapitulli I Standardi II.1]*

4.2 Rregullat dhe kërkesat e provimeve për zbatimin e tyre janë përcaktuar qartësisht në Rregulloret e AFMM-së. **[2 Kapitulli III nenet 16-19]** Megjithëse studentët angazhohen në punë në grup përgjatë tri viteve të studimit të tyre, vlerësimi i tyre bëhet individualisht. **[M2; M5]** E gjithë puna praktike është kryer në grupe, të formuara sipas specializimeve të ndryshme të studentëve, por secili departament i vlerëson studentët individualisht në fushat e skenarit, regjisorës, kameras dhe montazhit kundrejt çdo funksioni që mbulojnë. Struktura e mësimdhënies për secilën lëndë bëhet e qartë nga pedagogu që në fillim. **[M5; M4]** Çdo student është plotësisht i ndërgjegjshëm për zbatimin e procedurës së vlerësimit. **[M3; M5]** AFMM-ja përdor gjithashtu këndin e njoftimeve (në katin e parë përballë derës së hyrjes kryesore) për publikimin e procedurave javore të praktikës së mësimdhënies dhe planeve të detyrueshme të zbatimit, veçanërisht për xhirimet e filmave. **[tur në terren]** Provimet teorike ruajnë anonimitetin e studentëve, ndërsa paraqitja e praktikës së mësimdhënies bëhet përballë studentëve të tjerë dhe pedagogëve përkatës. **[M3; M5]** Nuk ka dokumente të procedurës zyrtare të ankimimit të notës, i cili nuk sanksionohet në Rregulloret e AFMM-së. **[2]** Në rastin e një ankese, studenti shkon drejtpërdrejtë te pedagogu ose te Rektori, i cili mund të lejojë riparqitjen e punimit. **[M3; M5]** Për sa i përket **Standardit II.2 të Kapitullit I**, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e një procesi të qartë për menaxhimin e ankesave të studentëve për notat e tyre të provimeve si **dobësi** dhe **rekomandon** që Akademia të dokumentojë qartësisht dhe të zbatojë në vazhdimësi procesin e menaxhimit të ankesave të studentëve për notat e tyre të provimeve. *[Kapitulli I Standardi II.2]*

4.3 Praktika e pyetjes së studentëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënies në mënyrë anonime u ndoq deri në vitin 2008. **[31]** Që prej atij viti, praktika nuk është përdorur pasi disa studentë nuk morën pjesë në anketime. Sipas stafit kjo vjen si rrjedhojë e marrëdhënieve që krijohen midis studentëve dhe pedagogëve për shkak të numrit të ulët të studentëve (aktualisht 15), që vështirësojnë anonimitetin e reagimeve. **[M2]** Kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 2.3. Stafi i AFMM-së po konsideron krijimin e një sistemi online, ku do të ruhet anonimiteti i studentëve, por në këtë drejtim nuk ka pasur ende asnjë ecuri. **[M2; M3]** Programet i nënshtrohen përmirësimit të

vazhdueshëm për shkak të ndryshimeve në ligj, ndryshimeve sociale, ndryshimeve të kërkesave të tregut për profesione si drejtorë, kameramanë dhe specialistë të tjerë. Gjithashtu, ato zhvillohen për shkak të përfshirjes dhe bashkëpunimit të AFMM-së në projekte me partnerë të huaj. **[M5; 12]** Megjithatë, studentët nuk janë pjesë e përmirësimit të procesit të mësimdhënies ose kurrikulës, dhe mendojnë se mendimet e tyre nuk merren seriozisht. **[M3]** Në këtë kuadër, çështjeve të ngritura nga Këshilli Studentor nuk u kushtohet rëndësia e duhur. **[M2]** Studentët pranojnë ndryshimin ndërmjet teorisë dhe praktikës, dhe disa prej tyre identifikuan për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm nevojën për më shumë teori, edhe pse ata i vlerësojnë aftësitë praktike që po zhvillojnë. **[M3]** Stafi akademik shpjegoi se teoria është pakësuar vazhdimisht, për t'iu kushtuar më shumë rëndësi aftësive praktike. **[M5]** Kjo tregon mungesën e angazhimit të studentëve në diskutimet rreth problemeve dhe mundësive, si dhe mosmarrjen parasysh të mendimeve të studentëve në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Nuk ka të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve **[dok. shtesë 0]** dhe kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 1.8. Megjithatë, gjatë mbledhjes me ish studentët dhe partnerët u vërtetua se niveli i tyre i punësimit është i lartë në tregun e punës dhe se ka shumë shembuj të çmimeve që studentët kanë fituar në festivalet e filmit ose konkurse ndërkombëtare. **[M1; tur në terren]** Alumni dhe partnerët, duke përfshirë punëdhënësit, nuk janë pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. **[M6] [Kapitulli I Standardi II.3]**

4.4 Mungon mbledhja dhe analiza sistematike e të dhënave për punësimin e të diplomuarve (shihni gjithashtu pikat 1.8 dhe 5.9), si dhe pyetësorët e studentëve nuk janë përdorur për mbledhjen e reagimeve (shihni gjithashtu pikën 2.3). Këto çështje ndikojnë në përputhshmërinë me **Standardin II.3 të Kapitullit I**, lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 2.3. Kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 2.3, si dhe dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 1.8. **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.5 AFMM-ja nuk ka një strukturë mbështetëse të përshtatshme për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, si dhe nuk ka njësi të pavarur të vlerësimit. Këshilli Akademik nuk është shumë aktiv, edhe pse funksioni i tij është sanksionuar në Statut, dhe studentët janë të paqartë për rolin e tij (shihni gjithashtu pikën 5.7). **[1; M2]** AFMM-ja nuk ka politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në RVV **[RVV fq.17]** përcaktohet se Njësia e Prodhimit ofron, garanton, kontrollon dhe menaxhon cilësinë teknike të filmave të studentëve, por nuk ka një proces nëpërmjet të cilit AFMM-ja të monitorojë, vlerësojë dhe zhvillojë sistematikisht të gjithë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë teorinë dhe praktikën, stazhet dhe vlerësimin. Cilësia e mësimdhënies vlerësohet nga cilësia e filmave të prodhuar dhe pranimi i tyre në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe jo sipas parimeve pedagogjike. **[M6; M5; RVV fq.17]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e sistemit sistematik dhe strukturës për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si **dobësi** dhe **rekomandon** që Akademia duhet të ngrëjë dhe të vërë në punë një proces sistematik dhe një strukturë të përshtatshme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies brenda 18 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. Kjo gjë do të trajtohet në Standardin II.4 të Kapitullit I dhe do harmonizohet me veprimet lidhur me **Standardin II.3** më sipër. **[Kapitulli I Standardi II.4]**

4.6 Ligji nr. 80/2015 (Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë), neni 94 (Struktura e kërkimit shkencor) parashikon që veprimtaria kërkimore të kryhet në institucionet e arsimit të lartë, institute dhe qendra ndër-institucionale të kërkimit dhe zhvillimit, si dhe në institutet e kërkimit dhe zhvillimit brenda ministrive. AFMM-ja është një Akademi me status të veçantë (Kapitulli III, seksioni I, neni 17, pikat 5 dhe 6), dhe si rrjedhojë nuk i kërkohet të ndërmarrë kërkim shkencor. prandaj, Standardet Shtetërore të Cilësisë **Kapitulli II Standardet I.1, I.2, I.4, I.5, I.6, I.7** dhe **I.8** nuk zbatohen dhe janë përjashtuar nga ky vlerësim. Megjithatë, në RVV u ofrua

informacion për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe për kërkimin rreth temave për të cilat studentët po krijojnë filmat e tyre, [RVV fq.17] dhe stafi i AFMM-së (zakonisht katër ose pesë për vit) ka qenë pjesë e disa konferencave ndërkombëtare, projekteve dhe festivaleve të filmave. [GID] Studentët dhe të diplomuarit kanë marrë pjesë edhe me filma në konkurse dhe festivale ndërkombëtare të filmave. [M1, M3, M5; M6] Si rrjedhojë, brenda kufizimeve të statusit të AFMM-së **Standardi I.3 i Kapitullit II** është përmbushur. **[Kapitulli II Standard 1.1; Kapitulli II Standardi 1.2; Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6; Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8]**

4.7 Struktura e programit është përcaktuar qartësisht si e përfshirë në Statutet dhe Rregulloret e Akademisë. Ajo ka pësuar ndryshime që prej themelimit të AFMM-së, për të pasqyruar ndryshimet në shoqëri dhe në kërkesat e tregut për rolet në media, si dhe në kërkesat e procesit të Bolonjës dhe akreditimit. Studentët përvetësojnë njohuri të mira themelore për aftësitë e kërkuara profesionale, që i pajisin ata si duhet për punësim, ndërsa ndryshimet më të fundit kanë rritur përqindjen e punës praktike në program. Kërkesat e vlerësimit janë përcaktuar qartësisht në Rregullore, por AFMM-së i mungon sistemi i ankimimit, pasi nuk përfshihet në asnjë dokument institucional, dhe nuk ka asë proces zyrtar për rishikimin e notave të studentëve. Që prej vitit 2008, studentëve nuk u është kërkuar të plotësojnë pyetësorë për cilësinë e mësimdhënies dhe studentët shprehen se mendimet e tyre nuk janë marrë në konsideratë. Këshilli Akademik nuk është shumë aktiv, edhe pse funksioni i tij është parashikuar në Statut. Si rrjedhojë, studentët nuk janë pjesë e procesit të përmirësimit të kurrikulës. Të dhënat për punësimin e të diplomuarve nuk janë regjistruar ose analizuar në mënyrë sistematike, dhe si rrjedhojë nuk mund të ofrojnë informacion për vlerësimin e programit. Si njësi e pavarur për vlerësimin e cilësisë, ashtu dhe struktura e duhur për vlerësimin e mësimdhënies dhe për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies mungojnë. Për këto fusha janë dhënë disa rekomandime. Pavarësisht se AFMM-ja ka lidhje ndërkombëtare dhe angazhohet në projekte të financuara me organizata partnere brenda dhe jashtë vendit, nuk i kërkohet të ndërmarrë kërkime.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një procesi për menaxhimin e ankimeve të studentëve për notat e provimeve (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- mospërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme për mundësimin e shprehjes së mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e AFMM-së (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli I Standardi II.3**)
- mungesën e të dhënave sistematike për punësimin e të diplomuarve, që sjell edhe mungesën e analizës së tyre, ku do të bazohet përgatitja e kurrikulës (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi II.3**)
- mungesën e një strukture dhe procesi sistematik për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- dokumentimin e qartë dhe zbatimin në vazhdimësi të procesi të menaxhimit të ankimeve të studentëve për notat e provimeve, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- ripërdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e reagimeve ose mekanizmave të tjera të përshtatshme për mundësimin e shprehjes së mendimeve të studentëve rreth cilësisë së leksioneve dhe punës së stafit akademik, në përputhje me Statutet e tyre, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pikat 2.3, 4.3 dhe 4.4; **Kapitulli I Standardi II.3**)
- ndjekjen e një procesi sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, dhe sigurimin e përdorimit të informacionit për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi II.3**)
- krijimin dhe zbatimin e një procesi sistematik dhe strukture të përshtatshme për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies brenda 18 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Mbështetja që iu ofrohet studentëve nga AFMM-ja përcaktohet kryesisht nga madhësia e institucionit. Gjatë vitit akademik 2016-2017, Akademia ofroi programin e ciklit të parë me kohë të plotë për 15 studentë, ku numri përgjithshëm i personelit përbëhej nga tre pedagogë me kohë të plotë, 10 pedagogë me kohë të pjesshme, 4 anëtarë të personelit administrativ me kohë të plotë, dhe 3 anëtarë të personelit të mirëmbajtjes dhe sigurisë me kohë të plotë. **[6]** Nga kjo, del se raporti pedagog me kohë të plotë/student është 11:1. Studentët ndjekin një program studimi të mbështetur në praktikë, duke përfshirë përdorimin masiv të pajisjeve dhe lehtësirave teknike (kamera, pajisje montazhi, studio zëri dhe projektimi), dhe si rrjedhojë, ata i ndjekin rregullisht studimet në Akademinë Marubi dhe kanë kontakte ditore të rëndësishme me stafin e mësimdhënies dhe personelin administrativ. Prandaj, Akademia nuk ka as nevojë dhe as kapacitete për struktura të ndara për prirjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Programi i ofruar nga Akademia përshkruhet qartë në faqen e saj të internetit, si dhe publikohet në panairët e studentëve. **[Faqja e internetit; RVV]** Procedurat e pranimeve janë përcaktuar në faqen e internetit dhe Rregullore, dhe përfshijnë një intervistë përzgjedhëse, detyrë me shkrim dhe vlerësim të punimeve të mëparshme nga një panel prej tre anëtarësh. **[2]** Pjesa më e madhe e studentëve e vizitojnë Akademinë para se të aplikojnë, dhe bëjnë një tur individual në ambientet e saj, si dhe takohen me studentët aktualë. Shumë aplikantë ndjekin gjithashtu diskutime publike, shfaqje dhe aktivitete të tjera kulturore të organizuara nga AFMM-ja. **[RVV; M2; M4]** Akademia nuk synon drejtpërdrejt studentët e huaj, pasi procesi i saj i pranimeve është konkurrues dhe kërkon që studentët të flasin shqip ose anglisht. Megjithatë, ka edhe aplikime nga studentët e huaj, si dhe Akademia ka pranuar studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia (Preshevë-Medvegje dhe Bujanovc). **[6] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 AFMM-ja komunikon me studentët dhe publikun e gjerë nëpërmjet faqes së saj të internetit, që është si në gjuhën shqipe edhe atë angleze, si edhe nëpërmjet faqeve në Facebook, Instagram, dhe pranisë së saj në YouTube dhe Livestream Channel. **[RVV; faqja e internetit; M2; M4]** Gjithashtu, komunikimi me studentët aktualë është bërë nëpërmjet emailit, mesazheve dhe programeve të rregullta javore të mësimdhënies, që shfaqen në këndin e njoftimeve të Akademisë. **[33; M2]** Administratori qarkullon gjithashtu një buletin informativ elektronik. **[34]** Dosjet personale në format të shtypur dhe elektronik për secilin student, duke përfshirë adresat dhe numrat e kontaktit, mbahen në Zyrën e Administrimit, së bashku me dosjet e të gjithë ish studentëve. **[RVV; M2] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.3 Akademia nuk ka një Zyrë të posaçme për Karrierën ose Këshillimin. Të gjitha funksionet administrative, duke përfshirë edhe orientimin dhe udhëzimin e studentëve të rinj kryhen nga Zyra e Administratës dhe nga dy anëtarët e personelit të saj me kohë të plotë, të mbështetur nga Rektori dhe Përgjegjësi i Administrimit. **[RVV; M2]** Programi i ciklit të parë të ofruar nga Akademia ka natyrë zhvilluese dhe progresive lidhur me aftësitë dhe njohuritë, ndërsa studentët krijojnë një ide të rëndësishme për rrugët e mundshme të karrierës dhe mundësive të punësimit, nëpërmjet kontakteve me prodhuesit dhe regjisorët e filmave, si dhe gjatë stazheve në industrinë e medias. **[3; 6; 21; M2; M4]** Studentët e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm treguan se zhvillimi personal dhe këshillat për karrierën vijnë kryesisht nga pedagogët e tyre dhe kontaktet me prodhuesit e filmave dhe praktikantët e tjerë. Studentët pranojnë se Akademia ka të dhëna të mira në ofrimin e mundësive për punësim në industrinë e medias. **[M4]** Në rastet kur studentët duan të vazhdojnë më tej studimet dhe jo të punësohen, Akademia iu ofron mbështetje nëpërmjet kontakteve të saj me shkollat ndërkombëtare të filmit, si dhe iu jep këshilla dhe referenca gjithëpërfshirëse. **[RVV; M1; M2; M6]** Kjo gjetje mbështet karakteristikën e **praktikës së mirë** në pikën 1.9. **[Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 Akademia nuk bën diskriminime pozitive në favor të grupeve të caktuara të studentëve. **[M5]** Procesi i pranimit është konkurrues dhe mbështetet në aftësi dhe

potencial. Projektimi i godinës Marubi e kufizon aksesin e karrigeve me rrota, edhe pse British Council i ka dhuruar asaj një rampë në hyrjen kryesore. **[M5]** Akademia nuk ka burime për mbështetjen e studentëve në vështirësi financiare, por i ka mbështetur studentët duke kërkuar bursa nga Qendra Kombëtare e Filmit. **[RVV; 36] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 Materialet kryesore të mësimnxënies që kërkohen nga studentët janë pajisje për prodhimin dhe montazhin e filmave, të cilat janë pajisje të shtrenjta dhe kërkojnë përditësim të vazhdueshëm. Akademia ofron një gamë moderne pajisjesh, edhe pse studentët e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm treguan se do të dëshironin akses më të shpejtë në kamerat dhe pajisjet elektronike më të fundit. **[M2; M4; M5; 6]** Për të gjitha pajisjet e disponueshme mbahet një inventar. **[6]** AFMM-ja mirëmban dhe siguron burime për bibliotekën nëpërmjet librave dhe literaturës teknike dhe akademike kryesore, si dhe nëpërmjet një koleksioni të madh filmash. **[18; M2; M6]** Studentët kanë gjithashtu akses te burimet e Qendrës Kombëtare të Filmit, dhe nëpërmjet një marrëveshjeje që i jep stafit dhe studentëve akses falas, ata mund të aksesojnë edhe Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit. **[M6] [Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 AFMM-ja nuk i ofron të studentëve mentor personal. Megjithatë, secilit student i caktohet një anëtar i veçantë i stafit për t'i udhëzuar dhe këshilluar rreth prodhimit të filmave, që është i nevojshëm për përparimin nga njëri vit në tjetrin. **[RVV]** Megjithatë, natyra e kurrikulës dhe numri i madh i anëtarëve të stafit kundrejt numrit të pakët të studentëve do të thotë se studentët marrin këshilla individuale nga stafi dhe administratorët, si edhe mbështetje nga studentë të tjerë. **[RVV; 6; M1; M4; M5] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 Studentët nuk përfaqësohen në Këshillin Akademik apo në Bordin Këshillimor të Akademisë, që janë dy organet e saj vendimmarrëse kryesore. Në Statute parashikohet krijimi i Këshillit Studentor të AFMM-së, që përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur. **[1]** Dy të tretat e anëtarëve studentë mund të zgjidhen edhe për një mandat të dytë dyvjeçar, ndërsa Këshilli Studentor zgjedh një nga anëtarët e tij kryetar këshilli. Gjatë kryerjes së vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, kryetari i zgjedhur, çuditërisht, ishte student i vitit të parë. **[M1]** Statutet parashikojnë se kryetari i Këshillit Studentor duhet të mbajë kontakte të rregullta me Kancelarin e AFMM-së për të përfaqësuar dëshirat dhe pikëpamjet e studentëve. **[1]** Këto mbledhje nuk u zhvilluan **[M1; M4]** (shihni gjithashtu pikën 1.1). Këshilli Studentor nuk mbledhet rregullisht dhe nuk përfiton lehtësira nga Akademia përveç aksesit në një sallë mbledhjesh (shihni gjithashtu pikat 2.15 dhe 4.3). Mbledhjet thirren kur Kryetari e sheh të nevojshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mosangazhimin e Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimnxënies të përcaktuar në Statute si **dobësi** dhe **rekomandon** që Akademia duhet të sigurojë angazhimin e Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimnxënies të përcaktuar në Statute, me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar. Kjo do t'i mundësojë AFMM-së përputhshmërinë me **Standardin III.7 të Kapitullit I. [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 Për shkak të sipërfaqes së vogël dhe burimeve të kufizuara, AFMM-ja nuk mbështet veprimtari sportive ose ndonjë formë të shërbimeve mjekësore apo mbështetjes shëndetësore për studentët e saj, megjithëse bën këshillimin e tyre për përfitimin e sigurimeve shëndetësore. **[RVV; M2]** Akademia mbështet një larmi aktivitete dhe veprimtarish kulturore, kryesisht orë mësimore të veçanta, shfaqje të veçanta, dhe seminare dhe festivale të hapura për publikun, alumni dhe profesionistët e medias. Studentët jo vetëm që i ndjekin, por edhe marrin pjesë në aktivitete të tilla. **[RVV; 6; M1; M4; M6]** Kjo gjetje mbështet karakteristikën e praktikës së mirë në pikën 1.9). **[Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Kurrikula e Akademisë përqendrohet veçanërisht në përvetësimin e njohurive dhe aftësive që do iu mundësojnë studentëve punësim më të shpejtë në industrinë e filmit dhe medias brenda dhe jashtë vendit. Partnerët, punëdhënësit dhe alumit e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e pohuan punësueshmërinë e të diplomuarve të AFMM-së. **[M6]**

Akademia iu mundëson studentëve të saj kontakte të mira dhe akses te punëdhënësit e mundshëm në industrinë e medias, si dhe në emaile qarkore për mundësitë e punësimit që mund të krijohen nëpërmjet këtyre kontakteve. [RVV; M1; M4] Ruajta e marrëdhënieve ndërmjet AFMM-së dhe ish studentëve të saj që punojnë në industrinë e filmit dhe medias është burim i dobishëm për këshillimin dhe mundësitë për studentët e saj. [M1; M4; M6] Megjithatë, këto kontakte nuk ruhen në mënyrë sistematike nëpërmjet regjistrimit online dhe faqes së internetit. [M2; M6] Ngritja e një sistemi online është një ndër qëllimet e AFMM-së. [RVV] Akademia mban dosje në format të shtypur për të gjithë ish të diplomuarit, dhe këto dosje përditësohen kur informacioni është i disponueshëm për vendet e punësimit të tyre. Për sa i përket **Standardit III.9 të Kapitullit I**, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** mungesën e të dhënave sistematike për punësimin e të diplomuarve, që sjell edhe mungesën e analizës së tyre, ku do të bazohet përgatitja e kurrikulës dhe **rekomandon** që Akademia të krijojë një proces sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve dhe të sigurojë përdorimin e informacionit për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar. Kjo gjetje mbështet dobësinë dhe rekomandimin e identifikuar në pikën 1.8. [**Kapitulli I Standardi III.9**]

5.10 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se Akademia i përmbush kryesisht standardet e cilësisë për studentët dhe mbështetjen e tyre. Për shkak përmasave të vogla të AFMM-së, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pati mundësinë t'i takonte të gjithë studentët dhe stafin, si dhe një grup ish studentësh. Ndërkohë që Akademia nuk ka instrumente dhe burime për ofrimin e një game mbështetjeje të institucionalizuar për studentët, gjë që mund të ofrohet në një institucion më të madh (zyrë karriere, shërbime sportive dhe shëndetësore, lehtësira për studentët me aftësi të kufizuara, bursa për studentët që kanë vështirësi financiare), ajo i kompenson këto kufizime nëpërmjet mbështetjes së studentëve në mënyra individuale dhe veçanërisht nëpërmjet sigurimit që pajisjet e nevojshme për prodhimin e filmave të jenë lehtësisht të disponueshme dhe sa më moderne që të jetë e mundur. Studentët e takuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishin mjaft të aftë dhe kishin pritshmëri të larta lidhur me aftësitë që ata do të përvetësojnë dhe mundësitë që do të kenë në dispozicion. Kontakti i shpeshtë dhe i vazhdueshëm ndërmjet të gjithë studentëve dhe stafit akademik e personelit administrativ është një element pozitiv. Megjithatë, marrëveshjet për mbështetjen e studentëve janë relativisht joformale dhe ndonjëherë josistematike. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka rekomanduar fushat ku AFMM-ja duhet të ngrejë sisteme më të formalizuara të mbështetjes së studentëve, dhe monitorimin lidhur me të dhënat për punësimin e të diplomuarve dhe angazhimin e Këshillit Studentor.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjet ndërkombëtare që kanë mundësuar organizimin e orëve të veçanta të specializuara dhe kontribute të tjera nga specialistë dhe profesionistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e prodhimit të filmave, qoftë fizikisht, apo nëpërmjet videokonferencave, për përmirësimin e studimeve të studentëve dhe përvojës së tyre kulturore (pikat 1.9, 5.3, dhe 5.8; **Kapitulli I Standardi III.3, Kapitulli I Standardi III.8**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mosangazhimin e Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimnxënies, që është përcaktuar në Statute (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- mungesën e të dhënave sistematike për punësimin e të diplomuarve, që sjell mungesën e analizës së tyre, ku do të bazohet përgatitja e kurrikulës (pikat 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- sigurimin e angazhimit të Këshillit Studentor në përmirësimin e procesit të mësimnxënies të përcaktuar në Statute me ndikim të menjëhershëm në marrjen në dorëzim të raportit përfundimtar (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- ndjekjen e një procesi sistematik për regjistrimin e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, dhe të sigurojë përdorimin e informacionit për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës brenda 12 muajsh nga marrja në dorëzim e raportit përfundimtar (pika 1.8, 4.3, 4.4, dhe 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

Dokumentacioni fillestar

GID	Dokument i Informacionit të Përgjithshëm në gjuhën angleze, i nënshkruar dhe vulosur nga Rektori
DOK 1	Dok. 1-Statute në gjuhën angleze.pdf
DOK 2	Dok. 2-Rregullore e AFMM-së
DOK 3	Dok. 3-vademecum AFMM 2016_2017 Eng.pdf
DOK 4	Dok. 4-Memorandum Mirëkuptimi i Institutit Italian të Kulturës.pdf
DOK 5	Dok. 5-VKM nr. 65, datë 03.02.2017.pdf
DOK 6	Dok. 6-Raport për vitin akademik 2015-2016
DOK 7	Dok. 7-Lista e pedagogëve aktualë me emrat, diplomat dhe profesionet
DOK 8	Dok. 8-Ftesë Florenc Papas JAVA LINDORE-Workshop Skenari për Talentet e Reja 2017.pdf; Dok. 8-Selection Sedicicorto IFFF 2016 (Forli, Itali)_Kapsula.pdf; Dok. 8 Akademia e Studentëve i jep çmimin Oscar_Irdit Kaso_2016.pdf
DOK 9	Dok. 9 (9.1) -Konferencë EFSN_2015.pdf; Dok. 9 (9.2) - Invitation conference technologie La Femis 2013.pdf; Dok. 9 (9.3) -Invitation Early Bird FF 2013.pdf; Dok. 9 (9.4) - Ftesë për festivalin SEECs 2017.pdf
DOK 10	Dok. 10-EU 10 dokument mjedisor 2013.pdf; Dok. 10-IFS Koleksion dokumentarësh 2012.pdf
DOK 11	Dok. 11-Festivali i Bashkëpunimit GoEast_2016.pdf; Dok.11MB për Projektin e Kinemasë Shqiptare_2016; Dok. 11-MM bashkëpunim FAMU2011; Dok. 11-MM bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Filmit.pdf; Dok. 11-MM rinovimi i IFS_2014.pdf; Dok. 11-MM Stavrakos 2014.pdf; Dok. 11- Themelimi i SEECs.PDF; Dok. 11-Mbështetje nga ambasada e SHBA-së_2015.pdf
DOK 12	Dok. 12-Programme të zhvilluara nga profesorë të huaj.pdf
DOK 13	Dok. 13-Pjesëmarrje të detajuara në festivale.pdf
DOK 14	Dok. 14-Programi i konferencës së Rrjetit Evropian të Shkollës së Filmit 2013.pdf
DOK 15	Dok. 15-Hartimi i modelit të kontratave.pdf; Dok. 15-Kontratë me kohë të plotë; Dok. 15-Kontratë me kohë të pjesshme
DOK 16	Dok. 16-Videokonferencë me David Lynch në vitin 2014, 2 fotografi në format.jpg
DOK 17	Dok. 17-Autorizim nga zjarrfikësit 2016.pdf
DOK 18	Dok. 18-Snapshot BookPedia dhe DVDPedia.pdf
DOK 19	Dok. 19-Plane të ambienteve dhe kampusit.pdf
DOK 20	Dok. 20-Regjistri i klasës 2016-2017 anglisht.pdf; Dok. 20-Arkivi i diplomës 2004_2016; Dok. 20-Fragmente të tezës së diplomës.PDF; Dok. 20-Regjistri elektronik i përgjithshëm i studentëve 2007-2016
DOK 21	Dok. 21-Përshkrim i programit arsimor.pdf
DOK 22	Dok. 22-Raport Përfundimtar_10 dok. komente EUD
DOK 23	Dok. 23-Numri i identifikimit në diplomë.pdf
DOK 24	Dok. 24-Kurrikula e Prodhimit të Dokumentarëve Alfred Diebold; Dok. 24-Kurrikula Kujtim Çashku Y1 Play Game; Dok. 24-Kurrikula Kujtim Çashku Y2 Regjistrura

DOK 25	Dok. 25-Model diplome së bashku me suplementin dhe notat
DOK 26	Dok. 26-Shembull i regjistrin të klasës për lëndën e zhvilluar në gjuhën angleze.pdf
DOK 27	Dok. 27-Vendim i komisionit të vlerësimit të tezës së diplomës 2016.pdf
DOK 28	Dok. 28-Shembull i fletës së vlerësimit të filmave.pdf
DOK 29	Dok. 29-Sintezë e secilës fletë vlerësimi të filmave
DOK 30	Dok. 30-Shembull i provimit me shkrim së bashku me vlerësimin e profesorit.pdf
DOK 31	Dok. 31-Pyetësor për vlerësimin e profesorëve nga ana e studentëve.pdf
DOK 32	Dok. 32-Njoftime për konferenca ndërkombëtare
DOK 33	Dok. 33-Email informues për studentët.pdf
DOK 34	Dok. 34-Ekstrakt i buletinit informativ.pdf
DOK 35	Dok. 35-Letër mbështetëse për Master.pdf
DOK 36	Dok. 36-Ekstrakt i kontratës për bursë.pdf
DOK 37	Dok. 37-Vendim i zgjedhjes së studentëve.pdf
DOK 38	Dok. 38-Miratim i shkollës verore.pdf
DOK 39	Dok. 39-Kontratë stazhi.pdf
DOK 40	Dok. 40-Letër nga shkolla e filmave CILECT për Qeverinë e Shqipërisë 2009.pdf
DOK 41	Dok. 41-Artikull i revistës Variety 2009.PDF

Dokumentacioni shtesë i kërkuar

DOK SHITESË 0	Shënime për listën e dokumenteve të kërkuara/ofruara
DOK SHITESË 5	Plani i zhvillimit – i përkthyer në gjuhën angleze 5-VKM nr. 65, datë 03.02.2017_ENG
DOK SHITESË 6	Raport për vitin akademik 2015/2016 - 6-raport për vitin akademik 2015-2016_ENG
DOK SHITESË 15	Kontrata pune në gjuhën angleze: 15-Hartimi i modelit të kontratave; 15- kontratë me kohë të plotë; 15- kontratë me kohë të pjesshme
DOK SHITESË 39	Kontratë për bursë – e përkthyer në gjuhën angleze 39-kontratë për bursë ENG
DOK SHITESË 42	42-Fragmente të PLANIT TË BIZNESIT OraFilm Marubi ENG 2014 faqe të planit të biznesit të përkthyer në gjuhën angleze dhe versioni origjinal në gjuhën shqipe : 42-Ekstrakt i PLANIT TË BIZNESIT OraFilm Marubi
DOK SHITESË 43	Llogaritë e audituara: 3 certifikimet e fundit për vitet 2014, 2015, 2016; 43-certifikime nga taksat 2015-2017
DOK SHITESË 44/1	Shembull i kohëve të fundit i procesverbalit të Këshillit Akademik që paraqet debate dhe diskutime: 44/1-Bashkimi_27.03.2013_ENG me versionin origjinal në gjuhën shqipe: 44/1-Mbledhja 27.03.2013
DOK SHITESË 44/2	Shembull i kohëve të fundit i procesverbalit të Këshillit Akademik që paraqet debate dhe diskutime: 44/2-Bashkimi_27.03.2013_ENG me versionin origjinal në gjuhën shqipe: 44/Mbledhja_15.12.2010

Mbledhjet

M1	Mbledhja 1 Rektori
M2	Mbledhja 3 Stafi i nivelit të lartë
M3	Mbledhja 3 Studentët
M4	Mbledhja 4 Personeli mbështetës
M5	Mbledhja 5 Stafi akademik
M6	Mbledhja 6 Alumni / punëdhënës / partnerë
M7	Mbledhja 7 Rektori dhe koordinatori institucional